

**Standardet
e cilësisë për fëmijët**

Standardet

për Përkujdesjen Jashtë-Shtëpisë të Fëmijëve në Evropë



Hyrje

Nga Benita Ferrero-Waldner, Komisarë evropiane për politikë të jashtme dhe fqinjësore në Evropë

Sot, BE po përballë me ndryshime kuptimplote ekonomike, politike, ambientore dhe shoqërore që ndikojnë tek fëmijët. Fëmijët që jetojnë me prindër të varfër ose që nuk mund të jetojnë me prindërit e tyre janë më të nënshtruar ndaj varfërisë, dëbimeve dhe diskriminimit, gjë që mund të shkaktojë që ata të bëhen edhe më të ndjeshëm ndaj abuzimeve, pakujdesive dhe eksploatimeve. Natyra dhe rrethanat e rritjes së fëmijëve ndikojnë në masë të madhe në gjendjen e fëmijës në jetë. Është për keqardhje fakti se përqindja e fëmijëve të BE-së që jetojnë në varfëri brenda BE-së është më e madhe se sa përqindja e të rriturve që jetojnë në varfëri. Prandaj, ne duhet të sigurojmë kushte adekuate jetësore dhe kujdes për të gjithë fëmijët.

Si Komisarë për marrëdhënie të jashtme dhe politikë evropiane për fqinjësi, unë në veçanti fokusohem në mbrojtjen efektive të të drejtave të fëmijëve, duke marrë parasysh nevojat e tyre individuale dhe mundësitë e zhvillimit, ku Bashkimi duhet të veproj si një udhëzues i ndritur për pjesën tjetër të botës. Promovimi, mbrojtja dhe përmbushja e të drejtave të fëmijëve janë bërë një prioritet i rëndësishëm politik në politikën e jashtme dhe të brendshme të BE-së. Të drejtat e fëmijëve përbëjnë një pjesë të të drejtave të njeriut që BE dhe shtetet anëtare janë të obliguara t'i respektojnë sipas traktateve ndërkombëtare dhe evropiane, përfshirë Konventën e KB-së për të drejtat e fëmijës dhe protokolet e saj, Qëllimet e zhvillimit të mileniumit, Konventën evropiane për të drejtat e njeriut dhe Kartë evropiane për të drejtat themelore.

Në këtë kontekst Kualiteti i Standardeve për fëmijët plotëson përpjekjet tona në zhvillimin e politikës, në veçanti në rastet ku fëmijët nuk mund të jetojnë me prindërit e tyre. Bazuar në tregime të vërteta jetësore, ata skicojnë standardet e përbashkëta që kanë për qëllim sigurimin dhe përmirësimin e mundësive të zhvillimit të fëmijëve dhe të adoleshentëve dhe të përkujdesjes ndaj fëmijëve të pastrehë në tërë Evropën. Jam e bindur se këto standarde përbëjnë një kontribut të vlefshëm dhe një hap të rëndësishëm drejt harmonizimit të sistemit tonë për përkujdesjen e fëmijëve në Evropë.

Benita Ferrero-Waldner

Komisarë evropiane për politikë
të jashtme dhe fqinjësore në Evropë



Falenderimi

Këto standarde asnjëherë nuk do të mund të zhvilloheshin pa pjesëmarrjen e vlefshme të 163 fëmijëve dhe adoleshentëve, 36 prindërve biologjik, 106 kujdestarëve dhe 24 anëtarëve të familjeve të zgjeruara, avokatëve dhe përfaqësuesve të qeverive nga e gjithë Evropa.

“ Pika tjetër kthesë ishte mënyra se si nëna kujdestare më është afruar kur ne u takuam për herë të parë. Mënyra e parë që unë e vëra re ishte mënyra e sjelljes së saj. Kjo më bëri të ndihem e relaksuar. Dhe ajo më tha, “ Unë jam vetëm njerëzore. Sot unë mund të ndihmoj ty, nesër ti mund të më ndihmosh mua”.

(Nëna nga Norvegjia, kodi 22.04.02)

Parathënie

Puna për të mirën e fëmijëve që janë pa përkujdesje prindërore është forcë e përbashkët shtytëse e tri organizatave tona. FNEK (Federata Ndërkombëtare për Edukimin e Komuniteteve), ONSF (Organizata Ndërkombëtare për Strehim Familjar) dhe SOS Fshati i fëmijëve. Përmes cilësisë për fëmijët (CPF), ne përpiqemi të përmirësojmë gjendjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore dhe përkrahim zhvillimin e tyre në kuptim të cilësisë së standardeve të përkujdesjes për të pastrehët.

Ky botim paraqet projektin e CPF-së dhe rezultatet e cilësisë së standardeve për përkujdesjen ndaj fëmijëve të pastrehë në Evropë.

Prapavija

Me miratimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (KDF e KB-së) në vitin 1989, qëllimeve të tri organizatave tona iu dha korniza ligjore ndërkombëtare.

Përkushtimi global për të respektuar, mbrojtur dhe përmbushur të drejtat e fëmijës e përforcon veprimtarinë tonë. Për shkak të rritjes së shkëlqes së të drejtave të fëmijëve në gjithë botën, ne u pajtuam që nuk mjafton të kemi vetëm përkushtime politike të ruajtura në traktatet ndërkombëtare as nuk ishte i mjaftueshëm shumëzimi i veprimeve që kishin për qëllim mbrojtjen e fëmijëve.

Duke pasur parasysh këtë, KDF është themeluar me një bindje të fortë që përmirësimi efektiv dhe i qëndrueshëm i gjendjes së përkujdesjes ndaj fëmijëve të pastrehë do të jetë i mundur vetëm përmes partneriteteve të forta. Kjo na sollti deri te bashkëpunimi i tri organizatave tona në krijimin e projektit dhe sigurimin e qasjes pjesëmarrëse në zhvillimin e saj.



Pas tre viteve hulumtimi dhe përpjekjeve të bashkuara të standardeve të tanishme të CPF-së, ne jemi të përkushtuar të forcojmë bashkëpunimin tonë dhe të zhvillojmë partneritete të reja në të gjitha nivelet për të promovuar standardet dhe mbrojtur të drejtat e fëmijëve pa përkujdesje prindërore në Evropë dhe në gjithë botën.

Korniza e Zbatimit

Për të thelluar vëmendjen, KDF e KB-së, për situatën e fëmijëve pa përkujdesje prindërore iu drejtua Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve në vitin 2004 dhe bëri thirrje për zhvillimin e “ Udhëzuesve të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e Fëmijëve pa Përkujdesje prindërore”. Në mënyrë të ngjashme, në vitin 2005, Këshilli i Komitetit të Ministrave të Evropës miratuan një rekomandim mbi të drejtat e fëmijëve që jetojnë në institucionet e banimit në shtetet anëtare. Cilësia për fëmijët (CPF) e plotëson këtë kornizë me standardet e veta cilësore që në mënyrë të drejtpërdrejtë të zbatohet nga praktikantët.

Sfidat e ardhshme janë për t’u siguruar që këto standarde të respektohen në nivelin vendor, dhe të bartin detyrat tona të përbashkëta për të siguruar të drejtat e barabarta për të gjithë fëmijët.

Ne shprehim falënderimin tonë të thellë ndaj të gjithë atyre që kanë kontribuar në zhvillimin e këtyre standardeve cilësore, përfshirë edhe vetë fëmijët dhe të rinjtë.

Ne, me entuziazëm mirëpresim dhe inkurajojmë të gjithë ata që janë të përkushtuar për përkrahjen e zbatimit të standardeve në të gjitha nivelet!

Monika Niederle
FICE International

Keith Henderson
IFCO

Helmut Kutin
SOS-Kinderdorf International



Përmbajtja

Korniza	8
Deklarata e Misionit	9
Vizioni	9
Misioni	9
Vlerat	9
Konceptet Themelore	10
Parimet	10
Referenca	10
Zhvillimi dhe Zbatimi i Standardeve	11
Qëllimi	11
Hulumtimi	11
Zhvillimi i Standardeve	12
Zbatimi i standardeve të cilësisë për fëmijët	12
Struktura dhe përmbledhja e standardeve të cilësisë për fëmijët	13
Struktura	13
Përmbledhja e standardeve të cilësisë për fëmijët	14
Standardet e Cilësisë për Fëmijët- Tema e Standardit 1:	
Procesi i vendim-marrjes dhe pranimit	18
Standardi 1: Fëmija dhe familja e tij/saj biologjike përkrahen gjatë procesit të vendim-marrjes	19
Standardi 2: Fëmija nxitet të marrë pjesë në procesin e vendim-marrjes	21
Standardi 3: Një proces profesional i vendim-marrjes siguron përkujdesjen më të mirë të mundshme për fëmijën	22
Standardi 4: Vëllezërit/motrat kanë të njejtën përkujdesje	24
Standardi 5: Kalimi në shtëpinë e re përgaditet mirë dhe zbatohet me ndjeshmëri	25
Standardi 6: Procesi i përkujdesjes jashtë-shtëpisë udhëhiqet nga një plan i përkujdesjes individuale	27

Standardet e Cilësisë për Fëmijët- Tema e Standardit 2:

Procesi i përkujdesjes	30
Standardi 7: Vendosja e fëmijës duhet të përshtatet me nevojat e tij/saj, situatën jetësore dhe ambientin shoqëror	31
Standardi 8: Fëmija mban kontakte me familjen e tij/saj biologjike	33
Standardi 9: Kujdestarët janë të kualifikuar dhe kanë kushte adekuate për punë	35
Standardi 10: Marrëdhënia e kujdestarit me fëmijën bazohet në mirëkuptim dhe respekt	37
Standardi 11: Fëmija nxitet të marrë pjesë aktive në marrjen e vendimeve që ndikojnë drejtpërdrejtë në jetën e tij/saj	39
Standardi 12: Përkujdesja për fëmijën ofrohet në kushte të duhura jetësore	41
Standardi 13: Fëmijët me nevoja të veçanta marrin përkujdesje të duhur	43
Standardi 14: Fëmija/i riu vazhdimisht përgatitet për të jetuar i pavarur	45

Standardet e Cilësisë për Fëmijët- Tema e Standardit 3:

Procesi i largimit nga përkujdesja	48
Standardi 15: Procesi i largimit nga përkujdesja planifikohet e zbatohet me kujdes të veçantë	49
Standardi 16: Komunikimi në procesin e largimit nga përkujdesja bëhet në mënyrë të duhur dhe të dobishme	51
Standardi 17: Fëmija/i riu nxitet të marrë pjesë në procesin e largimit nga përkujdesja	53
Standardi 18: Sigurohet përcjellja, përkrahja e vazhdueshme dhe mundësitë për kontaktim	55

Fjalori i terminologjisë kyçe **58**

Shtojca	59
Struktura e referencës së Konventës për të Drejtat e Fëmijës (KDF KB)	59
Konventa për të Drejtat e Fëmijës	64
Organizatrat partnere të CPF-së	82
Stampimi	84



Korniza

Për një sërë arsyes, qindra mijëra fëmijë në Evropë nuk mund të rriten me familjet e tyre biologjike, dhe si rezultat i kësaj ndërmirren intervenime zyrtare, për t'i dërgohen në përkujdesje jashtë-shtëpisë. Një numër i sistemeve të ndryshme të përkujdesjes i janë ofruar këtyre fëmijëve për të siguruar dhe përmirësuar mundësitë e zhvillimit të tyre. Një ambient i përkujdesjes joadekuate mund të vështirësoj këtë zhvillim dhe fëmijët mund të mbeten të cënuar dhe në rrezik nga shkeljet e të drejtave të tyre themelore.

Përkundër kësaj prapavije dhe përkundër vëmendjes së kushtuar kësaj teme me KDF të KB-së, në vitin 2004, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve ka bërë thirrje për zhvillimin e udhëzuesve të Kombeve të Bashkuara (KB) për mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore.

Në nivelin evropian, rekomandimet e Këshillimit të Evropës për të drejtat e fëmijëve që jetojnë në institucione banimi po ashtu ofrojnë një kornizë për të punuar me fëmijët pa përkujdesje prindërore.

Në kontekstin evropian, organizatat ndërkombëtare për përkujdesjen e fëmijëve, FNAK, ONSF, dhe SOS Fshati i fëmijëve duke shfrytëzuar përvojat e tyre po ashtu kanë identifikuar një nevojë të konsiderueshme për zhvillimin e standardeve cilësore në fushën e përkujdesjes së fëmijëve jashtë shtëpisë. Në Evropën e cila është fokusuar kryesisht në zhvillimin ekonomik, iniciativat pan-evropiane janë po ashtu të nevojshme për të përballuar sfidat shoqërore.

Përkundër kësaj prapavije, tri organizatat ndërkombëtare për përkujdesjen e fëmijëve, FNAK, ONSF, SOS Fshati i fëmijëve në mars të vitit 2004 kanë nisur një projekt me qëllim që të sigurojnë dhe përmirësojnë mundësitë e zhvillimit të fëmijëve dhe të rinjve në përkujdesjen e fëmijëve jashtë-shtëpisë në Evropë.

Deklarata e Misionit

Vizioni

Deklarata e vizionit të cilësisë për fëmijët thotë:

Fëmijëve pa përkujdesje prindërore duhet të iu ipet mundësia që të rregullojnë të ardhmen e tyre me qëllim që të bëhen të sigurtë në vetvete, me vetëbesim dhe pjesëmarrës në shoqëri, duke jetuar në ambient përkatës, mbrojtës dhe të dashur, që promovon tërë potencialin e tyre.

Misioni

Misioni i cilësisë për fëmijët është që të përmirësoj gjendjen dhe mundësitë e zhvillimit të fëmijëve në përkujdesjen jashtë-shtëpisë, që nënkupton këto qëllime:

- Themelimi i një rrjeti të aksionarëve që do të mbronin të drejtat e fëmijëve në përkujdesjen jashtë-shtëpisë
- Zhvillimi i cilësisë së standardeve evropiane bazuar në përvojën dhe praktikën e mirë të njerëzve që janë të përfshirë drejtpërsëdrejti.
- Promovimi i miratimit, zbatimit dhe vëzhgimit të cilësisë së standardeve për fëmijët në përkujdesjen jashtë shtëpisë në nivelin vendor dhe evropian

Vlerat

Cilësia për fëmijët ka pesë vlera kryesore të barabarta që janë marrë parasysh gjatë projektit. Këto janë:

Pjesëmarrja: Personat që drejtpërsëdrejti dhe në mënyrë aktive kanë qenë të përfshirë në projektin e përkujdesjes ndaj fëmijëve jashtë-shtëpisë që nga viti 2004: përfshinë fëmijët dhe të rinjtë që kanë përvojë në përkujdesjen jashtë-shtëpisë, familjet biologjike, kujdestarët dhe punëtorët social.

Diversiteti dhe përfshirja gjinore: Diversiteti dhe përfshirja gjinore e të gjithë atyre që kanë qenë të përfshirë në përkujdesjen ndaj fëmijëve jashtë-shtëpisë janë pasqyruar në proces.

Partneriteti: Njerëzit dhe organizatat e lidhura drejtpërsëdrejti me përkujdesjen e fëmijëve jashtë-shtëpisë kanë mundësi t'i bashkohen projektit në nivelin vendor ose ndërkombëtar.

Përkushtimi: Cilësia për fëmijët (CPF) i detyrohet KDF të KB-së.

Përgjegjësia dhe qëndrueshmëria: CPF është përgjegjëse për tri organizatat që e kanë themeluar projektin. Qëndrueshmëria e saj do të sigurohet përmes një rrjeti evropian që udhëhiqet nga tri organizatat, që do të sigurojnë promovimin e standardeve dhe zhvillimin e partneritetit, përkrahjen e përmirësimit të gjendjes dhe mundësitë e zhvillimit të përkujdesjes ndaj fëmijëve jashtë-shtëpisë.



Konceptet themelore

Parimet

Baza për Standardet e cilësisë për fëmijët (SCPF) është informatë e mbledhur nga tregimet e njerëzve që kanë përvojë në përkujdesjen jashtë-shtëpisë (tregimtarët). Pas analizimit të tregimeve CPF ka identifikuar një numër të deklaratave të përbashkëta brenda tyre. Këto janë klasifikuar si në fushat në vijim:

Komunikimi dhe pjesëmarrja:

Tregimtarët kanë shprehur rëndësinë e komunikimit të duhur dhe transparent gjatë procesit të përkujdesjes jashtë-shtëpisë. Rëndësia e të dëgjuarit dhe marrja parasysh e mendimit të shprehur po ashtu është theksuar nga tregimtarët.

Ndërhyrja nga shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve

Zgjidhja e menjëhershme dhe e duhur individuale për fëmijën përfshirë vendosjen e përbashkët të motrave e vëllezërve, përfshirja e familjes së origjinës dhe procesi i monitorimit ishin çështjen e përbashkëta të cekura nga tregimtarët.

Kujdesi

Temat e përbashkëta të identifikuar lidhur me përpërkujdesjen ishin: kalimi nga një përkujdesje në tjetrën, kontaktet në mes të fëmijëve, familjet biologjike dhe ato të zgjeruara dhe kujdestarët. Struktura, rregullat, ritualet, radhitja e limiteve, njohja dhe pranimi i kufizimeve- këto janë temat të cilat të rinjtë shpesh i kanë përmendur si të rëndësishme në jetën e përditshme gjatë jetës në përkujdesjen jashtë-shtëpisë.

Rëndësia e marrëdhënieve të qëndrueshme dhe dashurisë ndërmjet fëmijës dhe kujdestarit, lidhjet emocionale dhe përkrahja e potencialit të fëmijës po ashtu janë theksuar si të rëndësishme nga ana kujdestarit ndaj fëmijës/ të riut.

Largimi nga përkujdesja:

Për tregimtarët, aspektet kryesore që kujdestari duhet të marrë parasysh kur përgatit një fëmijë / të ri që të mbarojë përkujdesjen jashtë-shtëpisë janë: të përkrahë fëmijën/ të riun në vendim-marrjen e tij/saj dhe në krijimin e jetës private e sociale, ta përgatis atë për jetë të pavarur dhe të ofrojë përkrahje dhe këshilla gjatë procesit të pas përkujdesjes.

Struktura e Referencës

Standardet CPF janë zhvilluar në kornizën e KDF të KB-së, çdo standard i CPF-së pasqyron një ose më shumë parime themelore të KDF të KB-së : mosdiskriminimi, përkushtimi ndaj interesit më të mirë për fëmijën, e drejta për jetë, mbijetesa dhe zhvillimi, dhe respektimi i pikëpamjeve të fëmijës.

Zhvillimi dhe Zbatimi i Standardeve

Qëllimi

Standardet CPF janë zhvilluar që të informojnë, udhëheqin dhe ndikojnë tek palët e përfshira në përkujdesjen jashtë-shtëpisë ndaj fëmijëve që janë gati për të jetuar ose jetojnë në përkujdesjen jashtë-shtëpisë, familjet biologjike, fëmija/fëmijët e të cilave janë gati për të jetuar/ janë duke jetuar në përkujdesjen jashtë-shtëpisë, kujdestarët, menaxherët e organizatave të përkujdesjes, punëtorët social, punonjësit e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve, hulumtuesit e të rinjve/fëmijërisë, organizatat joqeveritare që punojnë në fushat e zhvillimit të të rinjve dhe fëmijëve, përfaqësuesit e autoriteteve publike në të gjitha nivelet.

Vendet e synuara

Austria, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Qipro, Republika e Çekisë, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Islanda, Irlanda, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Zvicra, Turqia, Mbretëria e Bashkuar.

Hulumtimi

Qëllimi i hulumtimit të CPF-së ishte të mbledhë tregime të praktikës së mirë në 32 shtete pjesëmarrëse, të analizohen ato dhe më pas të zhvillojë këto informata në standarde cilësore.

Metoda e mbledhjes së të dhënave nga ana e CPF-së ishte tregimi i ngjarjeve: kjo metodë siguron pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të intervistuesve në krijimin e bazave për standardet CPF.

Objektet e hulumtimit ishin tregimet e praktikës së mirë nga palët që kanë përvojë në përkujdesjen e fëmijëve jashtë shtëpisë.

Në sistemin e CPF-së janë mbledhur dhe analizuar 332 tregime nga 26 shtete. Mesatarja e tregimeve të mbledhura për shtet ishte 10.5. Në total prej 49% të tregimeve janë marrë nga fëmijët dhe të rinjtë që janë përballur me përkujdesjen jashtë-shtëpisë (grupi më i rëndësishëm demografik për projektin); 11, 5 % nga prindërit biologjik; 32% nga kujdestarët (SOS familje dhe ato strehuese, udhëheqës të të rinjve dhe personeli tjetër nga organizatat e përkujdesjes) dhe 7.5% nga të tjerët (punëtorë social, avokatë, etc).

Analiza e të dhënave dhe rezultatet

Qëllimi kryesor i kësaj qasje ishte kryerja e një analize me përmbajtje kualitative që është realizuar me leximin e informatave të tekstit (tregimeve) me qëllim të identifikimit të klasifikimeve të ndryshme: kategorive, koncepteve, pronësisë dhe të marrëdhënieve të tyre në tregime.

Grupi që ka analizuar tregimet ka bashkuar rezultatet në një informatë amë dhe mbi këtë bazë ka nxjerrë një raport duke shfrytëzuar të dhënat. Ky raport ka ofruar informata mbi përvojën, probabilitetin dhe nevojat e të investuarve. Kategoritë e identifikuar në tregime janë cekur më lart (shih më lart: konceptet themelore).



Zhvillimi i Standardeve

Ekipi i projektit (EP) të CPF-së ka iniciuar këshillime vendore në 32 shtete evropiane, në të cilat një nga tri organizatat është aktive. Një nga rezultatet kryesore të këtyre këshillimeve ishte emërimi i koordinatorëve vendor (KV) të cilët së bashku me grupet vendore (GV) është dashur të bëjnë hulumtime dhe të zhvillojnë standardet në nivelin vendor. Detyra e parë e GV-së ishte të mbledhë dhe analizojë tregimet që përmbajnë praktikë të mirë nga personat e përfshirë drejtpërsëdrejti në përkuqdesjen e fëmijëve jashtë-shtëpisë. Rezultatet e kësaj analize janë shfrytëzuar si bazë për zhvillimin e standardeve cilësore.

Drafti i parë i standardeve CPF ishte zhvilluar nga GV me përkrahje të EP-së. Ky draft dokument më tutje është zhvilluar gjatë tri takimeve të grupeve vendore me pjesëmarrje të rinjve nga CPF. Pas përfundimit të versionit të draftit, intervistuesit (tregimtarët) dhe anëtarët e GV-ve kishin mundësi që reagimet e tyre të ia dërgonin EP-së. Rekomandimet e tyre janë përfshirë në standarde në takimin e fundit të grupeve vendore.

Një ekip i përbërë nga një i ri dhe anëtarët e grupit vendor dhe ekipi i projektit i kontrolluan, redaktuan dhe përfunduan standardet.

Zbatimi i Standardeve CPF

Për të realizuar misionin e CPF në bazë të parimeve kryesore të barazisë, gjithëpërfshirjes dhe pjesëmarrjes, janë identifikuar dy qëllimet në vijim:

- Të përkrahet miratimi i standardeve të cilësisë për fëmijët në përkuqdesje jashtë shtëpisë në nivelin vendor dhe atë evropian
- Të promovohen standardet CPF dhe qasja dhe filozofia e tyre në nivelin vendor, evropian dhe atë global

Struktura dhe përmbledhja e standardeve cilësore për fëmijët

Standardet CPF janë zhvilluar për të siguruar dhe përmirësuar gjendjen dhe zhvillimin e mundësive për fëmijët dhe të rinjtë në përkujdesjen jashtë shtëpisë për fëmijët në Evropë. Standardet kanë për qëllim të përkrahin aksionarët në përkujdesjen jashtë shtëpisë për fëmijët dhe të rinjtë; këta janë fëmijët dhe të rinjtë, familjet biologjike dhe kujdestarët, organizatat e përkujdesjes, shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve si dhe institucionet qeveritare vendore dhe ndërkombëtare.

Struktura

Standardet CPF përbëhen nga 18 standarde që janë të organizuar në bazë të fazave të identifikuara gjatë periudhës së hulumtimit (a). Çdo standard CPF përbëhet nga katër elemente (b).

a) Temat e standardeve

Në këtë dokument, procesi i përkujdesjes jashtë shtëpisë është i ndarë në tri pjesë:

Procesi i vendimmarrjes dhe pranimit

Ky proces ka dy faza: vlerësimin e gjendjes së fëmijës me qëllim që të vendoset për më të mirë të mundur dhe hapat që shpiten në integrimin e fëmijës në situatat e ardhme jetësore të tij /saj.

Procesi i përkujdesjes

Procesi i përkujdesjes është periudhë ndërmjet procesit të pranimit dhe procesit të largimit. Përfshinë përkujdesjen e tanishme dhe përkrahjen nga kujdestari.

Procesi i largimit nga përkujdesja:

Ky është procesi përmes të cilit fëmija/ i riu bëhet i pavarur, kthehet tek familja e tij/saj biologjike ose vendoset diku tjetër. Kjo përfshinë përkrahjen e mëtejme që atij /asaj (në atë kohë) i jepet nga ish-kujdestari.

b) Elementet e Standardeve

Titulli dhe përshkrimi i standardeve

Deklaratë e qartë lidhur me nivelin e kërkuar të cilësisë. Standardi ofron strukturën dhe udhëzimin për punën e përkujdesjes ndaj fëmijëve jashtë shtëpisë.

Citatet

Citate të zgjedhura nga narrativet e tregimtarëve; ata janë të shifruar sipas bazës së të dhënave të CPF-së.

Përgjegjësitë

Një sërë detyra, funksione dhe pjesë të përcaktuara të autoritetit për të gjithë aksionarët e përfshirë në zbatimin e standardeve përkatëse.

Udhëzuesit

Kërkesat lidhur me zbatimin e standardeve përkatëse.

Shenjat e paralajmërimit

Përshkrimi i asaj se çka nuk duhet të ndodh nëse zbatohet standardi përkatës.



Përmbledhja

E Standardeve Cilësore për Fëmijët

Tema e standardit 1: Procesi i vendimmarrjes dhe pranimi

Standardi 1: Fëmija dhe familja e tij/saj biologjike përkrahen gjatë procesit të vendimmarrjes

Fëmija dhe familja e tij/saj biologjike kanë të drejtë në ndërhyrje nëse ata shprehin dëshirën për të ndryshuar situatën e tyre jetësore ose nëse situata e kërkon atë. Siguria dhe interesi më i mirë i fëmijës janë të prioritetit më të lartë. Fëmija dhe familja e tij/saj biologjike gjithmonë dëgjohen dhe respektohen.

Standardi 2: Fëmija nxitet të marrë pjesë në procesin e vendim-marrjes

Të gjitha palët e përfshira e dëgjojnë dhe e respektojnë fëmijën. Në mënyrë adekuate fëmija informohet për gjendjen e tij/saj, inkurajohet që të shprehë pikëpamjet e tij/saj dhe të marrë pjesë në këtë proces sipas nivelit të tij/saj të të kuptuarit.

Standardi 3: Një proces profesional i vendim-marrjes siguron përkujdesjen më të mirë të mundshme për fëmijën

Procesi i vendimmarrjes përfshinë dy çështje: Cila është zgjidhja më e mirë për fëmijën? A duhet të identifikohen nevoja për përkujdesje jashtë-shtëpisë, cila është vendosja më e mirë e mundshme për fëmijën?

Të gjitha palët e përfshira drejtpërsëdrejti në zhvillimin e fëmijës bashkëpunojnë duke shfrytëzuar ekspertizat e tyre përkatëse. Ata pranojnë dhe ndajnë informatat relevante lidhur me procesin e vendimmarrjes. Kur pranohen fëmijët me nevoja të veçanta, duhet të merren parasysh kërkesat e tyre specifike.

Standardi 4: Motrat/vëllezërit kanë të njejtën përkujdesje

Gjatë procesit të përkujdesjes jashtë-shtëpisë, vëllezërit/motrat kanë përkujdesje të përbashkët. Ata vendosen ndaras vetëm nëse kjo është në të mirë të tyre. Në rast të tillë, sigurohet kontakti në mes tyre përveç nëse kjo ndikon negativisht tek ata.

Standardi 5: Kalimi në shtëpinë e re përgatitet mirë dhe zbatohet me ndjeshmëri

Pas marrëveshjes për mënyrën e përkujdesjes, organizata e ardhshme e përkujdesjes përgatit pranimin e fëmijës. Mikëpritja duhet të bëhet në mënyrë graduale dhe të shkaktoj sa më pak përçarje që është e mundshme. Kalimi në vend të ri caktohet si një proces, qëllimi kryesor i të cilit është që të siguroj interesin më të mirë të fëmijës dhe mirëqenien e të gjitha palëve të përfshira.

**Standardi 6: Procesi i përkujdesjes jashtë-shtëpisë udhëhiqet nga një plan i përkujdesjes individuale**

Plani i përkujdesjes individuale bëhet gjatë procesit të vendimmarrjes për zhvillim të mëtutjeshëm dhe zbatohet gjatë tërë procesit të përkujdesjes jashtë shtëpisë. Ky plan ka për qëllim të udhëheqë zhvillimin e plotë të fëmijës.

Në përgjithësi, plani i përkujdesjes përcakton statusin e zhvillimit të fëmijës, parashtron qëllimet dhe masat dhe sqaron burimet e nevojshme për të përkrahur zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës. Çdo vendim relevant gjatë procesit të përkujdesjes jashtë shtëpisë udhëhiqet nga ky plan.

Tema e standardit 2: Procesi i përkujdesjes**Standardi 7: Vendosija e fëmijës duhet të përshtatet me nevojat e tij/saj, situatën jetësore dhe ambientin shoqëror**

Fëmija rritet në ambient gjithëpërfshirës, përkrahës dhe dashamirës. Mundësia që fëmija të rritet në rrethin e një familje dashamirëse përmbush këto kritere të rrethit.

Në vendosjen e re, fëmija ka mundësi të krijojë marrëdhënie të qëndrueshme me kujdestarin dhe të mbajë kontakte me rrethin e tij/saj shoqëror.

Standardi 8: Fëmija mban kontakte me familjen e tij/saj biologjike

Marrëdhënia e fëmijës me familjen e tij/saj biologjike inkurajohet, mbahet dhe përkrahet nëse kjo është në interesin më të mirë për fëmijën.

Standardi 9: Kujdestarët janë të kualifikuar dhe kanë kushte adekuate për punë

Para marrjes së përgjegjësisë për përkujdesje ndaj fëmijës, kujdestarët vlerësohen, zgjedhen dhe trajnohen. Ata vazhdimisht trajnohen dhe marrin përkrahje profesionale për të siguruar zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës.

Standardi 10: Marrëdhënia e kujdestarit me fëmijën bazohet në mirëkuptim dhe respekt

Kujdestari i kushton vëmendje individuale fëmijës dhe bënë përpjekje që të ngritë besimin dhe ta kuptojë atë. Kujdestari gjithmonë komunikon në mënyrë të hapur, të sinqertë dhe me respekt me fëmijën.



Standardi 11: **Fëmija nxitet të marrë pjesë aktive në marrjen e vendimeve që ndikojnë drejtpërdrejtë në jetën e tij/saj**

Fëmija njihet si ekspert i jetës së tij/saj. Fëmija informohet, dëgjohet dhe kuptohet seriozisht, dhe aftësia e tij/saj ripërtëritëse njihet si një potencial i fortë. Fëmija inkurajohet që të shprehë ndjenjat dhe përvojat e tij/saj.

Standardi 12: **Përkujdesja për fëmijën ofrohet në kushte të duhura jetësore**

Standardet jetësore dhe infrastruktura e organizatave të përkujdesjes përmbushin nevojat e fëmijëve lidhur me komoditetin, sigurinë, kushtet e shëndosha jetësore si dhe qasjen e lirë në arsimim dhe në komunitet.

Standardi 13: **Fëmijët me nevoja të veçanta marrin përkujdesje të duhur**

Kujdestarët vazhdimisht dhe në mënyrë të veçantë trajnohen dhe përkrahen për të përmbushur nevojat e veçanta të fëmijëve nën përkujdesjen e tyre.

Standardi 14: **Fëmija/ i riu vazhdimisht përgatitet për të jetuar i pavarur**

Fëmija/ i riu përkrahet në krijimin e së ardhmes së tij/ saj që të bëhet i sigurtë në vetvete, i pavarur dhe pjesëmarrës në shoqëri. Ai/ ajo ka qasje në arsimim dhe i jepet mundësia të fitoi shkathhtësi dhe të përvetësoi vlera për jetë.

Fëmija/ i riu përkrahet në zhvillimin e vetëbesimit. Kjo i mundëson atij/ asaj që të ndihet i fortë dhe i sigurtë dhe të përballet me vështirësi.



Tema e standardit 3: Procesi i largimit nga përkujdesja

Standardi 15: Procesi i largimit nga përkujdesja planifikohet dhe zbatohet me kujdes të veçantë

Procesi i largimit nga përkujdesja është një fazë vendimtare në procesin e përkujdesjes së fëmijës jashtë-shtëpisë dhe planifikohet e zbatohet me kujdes të veçantë. Kryesisht bazohet në planin e përkujdesjes individuale të fëmijës/të riut.

Fëmija/ i riu njihet si ekspert lidhur me cilësinë e përkujdesjes ndaj tij/ saj. Reagimi i tij/ saj është i rëndësishëm për zhvillimin e mëtutjeshëm të cilësisë të sistemit të përkujdesjes dhe shembujve të përkujdesjes përkatëse.

Standardi 16: Komunikimi në procesin e largimit nga përkujdesja bëhet në mënyrë të duhur dhe të dobishme

Të gjitha palëve të përfshira në procesin e largimit nga përkujdesja iu ofrohen informata relevante në pajtim me rolin e tyre në këtë proces. Në të njëjtën kohë, fëmija/i riu dhe familja e tij/saj biologjike kanë të drejtë në intimitet dhe siguri.

Të gjitha informatat komunikohen në atë mënyrë që është e kuptueshme dhe e duhur për fëmijën/ të riun dhe familjen e tij/saj biologjike.

Standardi 17: Fëmijës/të riut nxitet të marrë pjesë në procesin e largimit nga përkujdesja.

Procesi i largimit nga përkujdesja bazohet në planin e përkujdesjes individuale. Fëmijës/ të riut i ipet mundësia të shprehë mendimin dhe preferencat për gjendjen e tij/ saj të tanishme dhe për jetën në të ardhmen. Ai/aajo merr pjesë në planifikimin dhe zbatimin e procesit të largimit nga përkujdesja.

Standardi 18: Sigurohet përcjellja, përkrahja e vazhdueshme dhe mundësia për kontaktim

Pasi që fëmija/i riu largohet nga përkujdesja jashtë shtëpisë, ai/aajo ka mundësi të marrë ndihmë dhe përkrahje. Organizata e përkujdesjes përpiqet të sigurojë që ai/aajo procesin e largimit nga përkujdesja të mos e ndiej si një përçarje të madhe.

Nëse i riu ka arritur moshën madhore, organizata e përkujdesjes vazhdon të ofroj përkrahje dhe mundësi të mbajtjes së kontaktit.



Tema e Standardit 1

Procesi i vendim-marrjes dhe pranimit

Procesi i vendimmarrjes ka dy faza:

Faza e parë e procesit të vendimmarrjes përfshinë së pari vlerësimin e nevojave të fëmijës dhe gjendjen e tij/saj familjare dhe vendimin për zgjidhjen më të mirë të mundshme për fëmijën. Nëse kjo ndodh, përkujdesja jashtë shtëpisë është mundësia më e mirë për të përmbushur interesin më të mirë të fëmijës. Faza tjetër e procesit të vendimmarrjes fillon me identifikimin e vendosjes më të mirë të mundshme. Procesi i vendimmarrjes përfundon kur përcaktohet vendqëndrimi dhe të gjitha palët e përfshira bien dakord në mes veti.

Procesi i pranimit përfshin të gjitha aktivitetet lidhur me integrimin e fëmijës në situatën e tij/saj të ardhme jetësore. Të gjitha palët e përfshira drejtpërsëdrejti në zhvillimin e fëmijës marrin dhe ndajnë informata relevante për procesin e vendimmarrjes.

Kur pranohen fëmijët me nevoja të veçanta, merren parasysh kërkesat e tyre specifike.

Kjo fazë e standardit përfshinë standardet në vijim:

- Standardi 1: Fëmija dhe familja e tij/saj biologjike përkrahen gjatë procesit të vendimmarrjes
- Standardi 2: Fëmija nxitet të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes
- Standardi 3: Një proces profesional i vendimmarrjes siguron përkujdesjen më të mirë të mundshme për fëmijën
- Standardi 4: Motrat/ vëllezërit kanë të njejtën përkujdesje
- Standardi 5: Kalimi në shtëpinë e re përgatitet mirë dhe zbatohet me ndjeshmëri
- Standardi 6: Procesi i përkujdesjes jashtë shtëpisë udhëhiqet nga plani i përkujdesjes individuale

Standardi 1 Fëmija dhe familja e tij/saj biologjike përkrahen gjatë procesit të vendim-marrjes

Fëmija dhe familja e tij/saj biologjike kanë të drejtë në ndërhyrje nëse ata shprehin dëshirë për të ndryshuar gjendjen e tyre jetësore ose kur situata e kërkon një gjë të tillë. Përparësia më e madhe i ipet sigurisë dhe interesit më të mirë të fëmijës. Fëmija dhe familja e tij/saj biologjike përherë dëgjohen dhe respektohen

“ Isha tmerrësisht e frikësuar që do të humbi fëmijët e mi(...) Por, unë menjëherë e kam ndier se ende isha një person i rëndësishëm në jetën e tyre. Isha e përfshirë në gjithçka që ka ndodhur me fëmijët e mi. Jam ndier si pjesë e të gjithave (...) Gjithmonë kam mundur të ju tregoj fëmijëve të mi se unë isha e interesuar për ata dhe posaçërisht për arsye se mua më lejohej që të marrë pjesë në ngjarje të rëndësishme për fëmijët”

(Nëna nga Luksemburgu, kodi 18.04.01)

Vajza është 14 vjeçe dhe nuk dëshiron të shkoj në shtëpi. Ata takohen me Shërbimin për fëmijët për të biseduar për situatën. Ajo ka një kërkesë specifike: Ajo dëshiron familje të re. Ne organizojmë rrjetin e vajzës, kë e njuh ajo etj, për të fituar pikëpamjet e hollësishme. Nga kjo del se ka probleme domethënëse në komunikim ndërmjet nënës dhe të bijës. Unë i thash vajzës se do të ishte ide e mirë që të mblidhen të gjithë në një takim për të diskutuar se cilat janë vështirësitë e saja në situatën e tanishme.”

(Bashkëpunëtorë i Shërbimit për mbrojtjen e fëmijëve nga Norvegjia, kodi

22.07.01)

A) Përgjegjësitë

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve

- Menjëherë cakton një person përgjegjës për përkrahjen e fëmijës dhe familjes së tij/saj në procesin e vendimmarrjes dhe nëse është e mundur në tërë procesin e përkujdesjes jashtë shtëpisë.

B) Udhëzuesit

1. Personi përgjegjës për fëmijën është gjithmonë në dispozicion

Personi përgjegjës gjatë gjithë procesit të vendimmarrjes është në dispozicion të sqaroj gjendjen e fëmijës dhe të përkrahë fëmijën dhe familjen e tij/saj biologjike. Nëse është e mundur, personi përgjegjës vëzhgon dhe përkrahë tërë procesin e përkujdesjes jashtë shtëpisë.



2. Të gjitha palët relevante janë të përfshira në mënyrë të ndjeshme

Personi përgjegjës tregon interesim aktiv në perspektivat e ndryshme të situatës së fëmijës dhe informon të gjithë njerëzit e përfshirë për të drejtat e tyre. Ai/ ajo përshinë të gjitha palët relevante që mund të kontribuojnë në sqarimin e situatës së fëmijës dhe të ndihmojnë në gjetjen e një zgjidhje.

Ky person përgjegjës i dëgjon të gjitha palët e përfshira, i trajton me respekt të njëjtë dhe në mënyrë të ndershme paraqet mundësitë për fëmijën.

C) Shenjat paralajmëruese

- Fëmija dhe /ose familja e tij/saj biologjike nuk përkrahen kur ata kërkojnë ndihmë
- Tregimi i fëmijës injorohet ose nuk besohet
- Dëgjohe vetëm njëra anë e tregimit
- Palët e përfshira nuk trajtohen dhe respektohen në mënyrë të barabartë
- Informatat për të drejtat e fëmijës nuk ofrohen në mënyrë të duhur.

Standardi 2 Fëmija nxitet të marrë pjesë në procesin e vendim-marrjes

Të gjitha palët e përfshira dëgjojnë dhe respektojnë fëmijën. Në mënyrë adekuate fëmija informohet për situatën e tij/saj, inkurajohet që të shpreh pikëpamjet e tij/saj dhe të marrë pjesë në proces sipas nivelit të të kuptuarit të tij.

“I kam kontaktuar Shërbimi i Fëmijëve dhe ata e morrën përsipër situatën. Ata reagues menjëherë. Atë ditë, unë kuptova se Shërbimi i Fëmijëve me të vërtetë e mendonin më të mirën për mua. Madje, edhe me kanë përfshirë në vendimin se ku do të vendosesh”.

(Vajza nga Norvegjia, kodi 22.02.03)

“Vetë vajza dëshironte të përfshihej në procesin e përkujdesjes. Kjo ndodhi pas kërkesës së saj të dytë. Në fillim, ajo jetonte me të ëmën, por kur iu sëmur nëna ajo vazhdoi jetën me të atin. Vajza vizitonte në familje përkrahëse gjatë vikendit, pastaj një tjetër familje, që më vonë u bënë familja e saj strehuese”.

(Tregimi i një vajze nga Finlanda, kodi 8.02.02)

A) Përgjegjësitë

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve

- Fëmijës i japin të drejtë që të merr pjesë në tërë procesin e vendimmarrjes.
- I ofrojnë fëmijës të gjitha informatat relevante dhe sigurojnë pjesëmarrjen tij/saj

B) Udhëzuesit

1. Fëmija informohet plotësisht në mënyrë fëmijërore miqësore

Personi përgjegjës i ofron fëmijës të gjitha informatat relevante lidhur me situatën e tanishme dhe mundësitë për të ardhmen dhe siguron që ai/ajo ta kuptojë këtë informatë.

2. Mendimi i fëmijës merret me ndjeshmëri

Punonjësit e trajnuar në mënyrë profesionale nga Shërbimet për përkujdesjen e fëmijës e intervistojnë fëmijën në mënyrë fëmijërore miqësore.

3. Mendimi i fëmijës respektohet dhe konsiderohet me kujdes

Personi përgjegjës vlerëson me kujdes situatën e fëmijës dhe mundohet të gjej mënyrat që të sigurojë atë që mendimi i tij/saj është marrë parasysh.

C) Shenjat Paralajmëruese

- Fëmija nuk ka informata të mjaftueshme për situatën e tij/saj ose nuk e kupton informatën që i është dhënë.
- Mendimi i fëmijës injorohet.
- Fëmija nuk pajtohet me vendimin.



Standardi 3 Një proces profesional i vendimmarrjes siguron përkujdesjen më të mirë të mundshme për fëmijën

Procesi i vendimmarrjes përfshinë dy çështje: cila zgjidhje është në interesin më të mirë të fëmijës? A duhet të identifikohen nevoja për kujdes jashtë shtëpisë, cila është vendosja më e mirë për fëmijën? Të gjitha palët drejtpërsëdrejti të përfshira në zhvillimin e fëmijës bashkëpunojnë duke përdorur ekspertizat e tyre përkatëse. Ata pranojnë dhe ndajnë informata relevante lidhur me procesin e vendimmarrjes.

Në pranimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, merren parasysh kërkesat e tyre specifike.

*“Këshilltari për familjet strehuese i paraqet familjes së mundshme strehuese nevojat e fëmijës dhe nëse ata pajtohen, qendra e njofton fëmijën. Po ashtu, fëmijës i jepet një prezantim i detализuar për familjen e tij/saj strehuese. Qendra e njofton familjen strehuese me fëmijën dhe familjen biologjike para se fëmija të vendoset nën përkujdesjen e tyre”.
(Bashkëpunëtor nga Shërbimi për mbrojtjen e fëmijës nga Sllovenia, kodi 27.08.03)*

A) Përgjegjësitë

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës * Sigurojnë proces profesional në vendimmarrje
* Sigurojnë proces pjesëmarrës dhe transparent

Organizata e përkujdesjes * Ofron Shërbime për mbrojtjen e fëmijës me të gjitha informatat për llojin e përkujdesjes që ofron

B) Udhëzuesit

1. Procesi është pjesëmarrës dhe transparent

Personi përgjegjës siguron që të gjitha palët e përfshira të marrin pjesë në proces. Ai/ ajo mbledh të gjitha informatat dhe dokumentet në mënyrë të qartë. Personi përgjegjës informon të gjitha palët e përfshira në mënyrë të kujdesshme duke siguruar që të gjithë që janë të përfshirë të kuptojnë dhe të kenë qasje në informatat relevante.

2. Sigurohet bashkëpunimi me organet e jashtme

Personi përgjegjës siguron që profesionistë nga organizata të ndryshme të vlerësojnë gjendjen e fëmijës dhe të japin këshilla.

3. Ofrimi i informatës për pasojat e mundshme lidhur me vendvendosjen

Personi përgjegjës vlerëson në tërësi rrjedhën e mundshme të veprimit dhe siguron që të gjithë personat e përfshirë të jenë të informuar për pasojat e mundshme të vendvendosjes.

4. Nëse vendosja origjinale është joadekuate merret parasysh vendosja alternative

Personi përgjegjës siguron që gjatë procesit të vendimmarrjes nëse mundësia e parë e vendosjes nuk është adekuate, atëherë merret parasysh vendosja alternative.

5. Vendimi bazohet në fakte relevante

Personi përgjegjës siguron që hulumtimi të kryhet në tërësi dhe që të analizohen dokumentet e marra. Bazuar në këto të dhëna, merret vendimi i duhur që siguron interesin më të mirë për fëmijën.

6. Zgjidhet vendvendosja më e mirë për fëmijën

Shërbimi për mbrojtjen e fëmijës zgjedh vendvendosjen më të mirë duke i kushtuar vëmendje serioze prapavijës etnike, sociale, fetare dhe mjekësore të fëmijës. Së bashku me organizatën e përkujdesjes, siguron që vendosja të bëhet në ambient përkrahës, mbrojtës, të dashur dhe gjithëpërfshirës.

Kujdestari i mundshëm duhet të jetë i kualifikuar dhe të pranoj burime të mjaftueshme si dhe trajnime dhe mbikëqyrje të vazhdueshme me qëllim që ti mundësoj atij/ asaj që të kujdeset për fëmijën (ose për motrat/vëllezërit).

7. Organizatat e përkujdesjes bashkëpunojnë në rast se fëmija kalon prej një lloji të përkujdesjes në tjetrin

Nëse fëmija kalon nga një lloj i përkujdesjes në llojin tjetër, kujdestari i tanishëm dhe organizata e përkujdesjes përkrahin procesin dhe i ofrojnë kujdestarit të ardhshëm të gjitha informatat e nevojshme lidhur me fëmijën.

C) Shenjat Paralajmëruese

- Vendimi nuk është marrë në interes të fëmijës.
- Në vendosje nuk janë marrë parasysh nevojat e fëmijës, situata jetësore dhe /ose ambienti i mëparshëm social.
- Nuk ka vendosje alternative nëse vendosja paraqitet të jetë jo adekuate.
- Vendimi nuk bazohet në fakte.
- Nuk ka dokumentim të procesit.
- Nuk ka transparencë në informimit.
- Fëmija, familja biologjike dhe palët tjera përkatëse nuk përfshihen ose nuk e kuptojnë procesin.
- Vendimi është i papritur për fëmijën dhe familjen tij/saj biologjike.
- Nuk ka bashkëpunim me profesionistë të jashtëm



Standardi 4 Motrat/vëllezërit kanë të njejtën përkujdesje

Gjatë procesit të përkujdesjes jashtë shtëpisë, motrat/vëllezërit vendosen nën përkujdesje të përbashkët. Ata ndahen vetëm nëse kjo është në të mirë të mirëqenies së tyre. Në atë rast, sigurohet kontakti ndërmjet tyre përveç nëse kjo ndikon negativisht tek ata.

Një djalë, dy vëllezërit dhe dy motrat e tij iu kishin besuar SOS Fshatit. Motrat dhe vëllezërit mund të qëndronin së bashku në një shtëpi, në një familje të re me SOS nënën dhe dy fëmijët e saj. Ai u rrit në qetësi në Fshat dhe mbajti kontakte me të atin e tij, i cili i takonte ata shumë shpesh.”

(Tregimi për një djalë nga Italia, kodi 15.01.01)

A) Përgjegjësitë

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës

- Ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme që të sigurojnë vendosjen e përbashkët për motrat/vëllezërit.
- Zgjedhin një organizatë të përkujdesjes e cila lejon vendosjen e përbashkët për motrat/vëllezërit të moshave të ndryshme
- Caktojnë kontakte të rregullta ndërmjet motrave/vëllezërve nëse nuk janë të vendosur bashkë

Organizata e përkujdesjes • Lejon vendosjen e përbashkët të motrave/vëllezërve të moshave të ndryshme

Kujdestari • Përkrah kontaktin e rregullt mes motrave dhe vëllezërve nëse nuk janë së bashku

B) Udhëzuesit

1. Vëllezërit/motrat vendosen së bashku

Shërbimi për mbrojtjen e fëmijës siguron vendosjen e përbashkët për vëllezërit/motrat. Kurdoherë që të jetë e mundur dëshirat e vëllezërve/motrave plotësohen. Organizatës së përkujdesjes që vendos motrat/vëllezërit së bashku i ofrohet përkrahje dhe udhëzime praktike.

Organizata e përkujdesjes siguron strukturë adekuate për përkujdesjen e motrave/vëllezërve.

2. Mbahet kontakti ndërmjet motrave/vëllezërve nëse nuk janë së bashku

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës dhe organizata e përkujdesjes ofrojnë burime të nevojshme (p.sh ndihmë financiare) dhe përkrahje që vëllezërit dhe motrat që nuk janë vendosur së bashku të mbajnë kontakte. Kujdestari i ardhshëm informohet për vëllezërit/motrat e fëmijës që nuk janë të vendosur me atë.

C) Shenjat Paralajmëruese

- Motrat/ vëllezërit janë të ndarë.
- Arsyeja për ndarjen e motrave/vëllezërve nuk është e justifikuar e as nuk është në interes të fëmijëve.
- Organizata e përkujdesjes nuk ka strukturë adekuate që të kujdeset për motrat/vëllezërit.
- Motrat/vëllezërit e ndarë kanë shumë pak ose aspak kontakte.
- Kujdestarët nuk kanë informata për motrat/vëllezërit e fëmijës.



Standardi 5 Kalimi në shtëpinë e re përgaditet mirë dhe zbatohet me ndjeshmëri

Pas marrëveshjes për formën e përkujdesjes, organizata e ardhshme e përkujdesjes përgatit tërësisht pranimin e fëmijës. Mikëpritja duhet të bëhet në mënyrë graduale me qëllim që të shkaktoj sa më pak përçarje që është e mundur. Kalimi në vend të ri organizohet si proces i cili për qëllim kryesor ka të sigurojë interesin më të mirë të fëmijës dhe mirëqenien e të gjitha palëve të përfshira.

“Prindërit e ardhshëm strehues filluan të takohen me fëmijët por procesi i kalimit nuk ishte i nxitueshëm.(...) Ata takoheshin nga një ose dy orë; më pas ata i shtuan kontaktet e tyre. Ajo mban në mend se burri i saj i mblidhte fëmijët nga shtëpia ku banonin dhe i dërgonte në shkollë. Pas mbarimit të shkollës, ajo qëndronte me ata që ti bëjnë detyrat e shtëpisë dhe më pas i dërgonte në shtëpinë ku banonin.(..) Gjatë këtij procesi fëmijët ishin njoftuar edhe me anëtarët tjerë të familjes. Procesi zgjati gjashtë muaj deri sa përfundimisht ata u vendosën në vendbanimin strehues. Të gjithë ishin të gatshëm për shpërnguljen”

(Kujdestari nga Malta, kodi 10.06.01)

A) Përgjegjësitë

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës	●Sigurojnë përgatitjen profesionale dhe zbatimin e procesit të pranimit në bashkëpunim me organizatën e përkujdesjes dhe kujdestarin
Organizata e përkujdesjes	●Siguron që kujdestari të ketë burime adekuate dhe përkrahje që ta marrë fëmijën dhe të kujdeset për të
Kujdestari	●Përgatit një mirësearchje të duhur për fëmijën dhe siguron zbatim profesional të procesit të pranimit

B) Udhëzuesit

1. Procesi i pranimit përgatitet dhe zbatohet në mënyrë profesionale

Procesi i pranimit përgatitet dhe zbatohet në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha palët e përfshira. Ofrohet kohë dhe burime të mjaftueshme për përgatitjen e pranimit të fëmijës.

Personi përgjegjës nga Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës siguron që caktimet dhe marrëveshjet të diskutohen me të gjitha palët e përfshira dhe që ata të jenë real, të sinqertë dhe detyrues për të gjithë.

Shqyrtohet mundësia që organizata e përkujdesjes dhe kujdestari të ofrojnë përkujdesjen e nevojshme. Kjo analizë në veçanti, fokusohet nëse kujdestari ka kualifikim adekuat, vazhdimisht trajnohet dhe mbikëqyret dhe nëse ai/ajo është i pajisur me burime të nevojshme.



2. Familja biologjike përfshihet tërësisht në procesin e pranimit

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës dhe organizata e ardhme e përkujdesjes sigurojnë që fëmija dhe familja e tij/saj biologjike të jenë të përfshirë, të konsultohen dhe përkrahen gjatë procesit të pranimit.

3. Fëmija njoftohet me shtëpinë e tij/saj të ardhshme

Personi përgjegjës siguron që fëmija të ketë mundësi të njihet me shtëpinë e tij/ saj të ardhme dhe me kujdestarin.

4. Vendosja duhet të shkaktojë më pak përzjarje që është e mundur

Personi përgjegjës siguron që vendosja të shkaktoj sa më pak përzjarje që është e mundur ndaj fëmijës dhe familjes së tij/saj biologjike.

C) Shenjat Paralajmëruese

- Procesi i pranimit nuk përgatitet dhe nuk zbatohet në mënyrë profesionale.
- Kujdestari nuk është i përgatitur për marrjen dhe /ose përkujdesjen ndaj fëmijës.
- Kujdestari nuk ka në dispozicion burime të mjaftueshme.
- Kujdestari nuk bashkëpunon me Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës.
- Fëmija dhe familja e tij/saj biologjike kanë shumë pak ose aspak informata për familjen e re.
- Caktimet nuk janë reale, të ndershme dhe detyruese.
- Palët përkatëse nuk janë të përfshira në proces.
- Nuk ka kontakte ndërmjet fëmijës dhe kujdestarit të ardhshëm para pranimit.
- Nuk ka rast për mikpritje.
- Fëmija ndien se pranimi po shkakton përzjarje të konsiderueshme për familjen e tij/saj dhe/ose rrethin shoqëror



Standardi 6 Procesi i përkujdesjes jashtë shtëpisë udhëhiqet nga një plan i përkujdesjes individuale

Plani i përkujdesjes individuale bëhet gjatë procesit të vendimmarrjes që të zhvillohet dhe zbatohet më tutje gjatë tërë procesit të përkujdesjes jashtë shtëpisë. Ky plan ka për qëllim të udhëheq zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës.

Në përgjithësi, plani i përkujdesjes përcakton statusin zhvillimor të fëmijës, parashtron objektivat dhe masat dhe sqaron burimet e nevojshme për përkrahje të përgjithshme të zhvillimit të fëmijës.

Çdo vendim relevant gjatë procesit të përkujdesjes jashtë shtëpisë udhëhiqet nga ky plan.

“ Ekipi i institucionit (...) dhe një punëtorë social (...) caktuan një sërë takimesh me personelin, fëmijën dhe të vëllaun me qëllim që të njihen më mirë me situatën. Ata identifikuan nevojat e djalit dhe bënë një plan veprimi bazuar në shfrytëzimin e burimeve të mundshme dhe kufizimet e ndërhyrjeve profesionale”.

(Tregim për një djalë nga Bullgaria, kodi 3.01.03)

A) Përgjegjësitë

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës	<ul style="list-style-type: none"> • Janë përgjegjës për vlerësimin multi-disiplinor për potencialin e fëmijës dhe për krijimin e një plani të përkujdesjes individuale për udhëheqjen e zhvillimit të përgjithshëm të tij/saj.
Organizata e përkujdesjes	<ul style="list-style-type: none"> • Siguron që procesi i përkujdesjes jashtë shtëpisë të bazohet në një plan të përkujdesjes individuale • Siguron që plani i përkujdesjes të udhëheq përkujdesjen e ofruar. • Përkrah kujdestarin në zhvillimin e planit të përkujdesjes
Kujdestari	<ul style="list-style-type: none"> * Është përgjegjës për zbatimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të planit të përkujdesjes individuale.

B) Udhëzuesit

1. Themelohet një plan i përkujdesjes individuale

Në konsultim me ekipin multi disiplinor, Shërbimi për mbrojtjen e fëmijës krijon një plan të përkujdesjes individuale duke marrë parasysh burimet, prapavijën dhe potencialin e fëmijës.



2. Fëmija merr pjesë në zhvillimin e planit të përkujdesjes individuale

Sigurohet pjesëmarrja e fëmijës në krijimin dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të planit të tij/ saj të përkujdesjes individuale. Niveli i pjesëmarrjes varet nga niveli i tij /saj i të kuptuarit.

3. Plani i përkujdesjes individuale shqyrtohet herë pas herë

Kujdestari është përgjegjës për zbatimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të planit të përkujdesjes. Në konsultim me të gjitha palët e përfshira, plani i përkujdesjes herë pas herë azhurnohet.

A) Shenjat paralajmëruese

- Mungon vlerësimi i dokumenteve dhe nuk ka plan për fëmijën.
- Plani i përkujdesjes nuk përmbush nevojat e fëmijës.
- Në planin e përkujdesjes individuale nuk janë të përfshira të gjitha palët relevante.
- Palët e përfshira nuk pajtohen me planin e përkujdesjes individuale.





Tema e Standardit 2

Procesi i Përkujdesjes

Procesi i përkujdesjes është i përcaktuar si periudhë ndërmjet procesit të pranimit dhe procesit të largimit nga përkujdesja.

Fëmijët dhe të rinjtë në përkujdesjen jashtë shtëpisë përkrahen që të rregullojnë të ardhmen e tyre dhe të bëhet të sigurt në vetvete, të pavarur, anëtarë pjesëmarrës të shoqërisë. Kjo zhvillohet duke jetuar në ambient përkrahës, mbrojtës dhe të dashur.

Kjo temë e standardit përfshinë standardet në vijim:

Standardi 7: Vendosja e fëmijës duhet të përshtatet me nevojat e tij/saj, situatën jetësore dhe ambientin shoqëror

Standardi 8: Fëmija mban kontakte me familjen e tij/saj biologjike

Standardi 9: Kujdestarët janë të kualifikuar dhe kanë kushte adekuate për punë

Standardi 10: Marrëdhënia e kujdestarit me fëmijën bazohet në mirëkuptim dhe respekt

Standardi 11: Fëmija nxitet të marrë pjesë aktive në marrjen e vendimeve që ndikonjnë drejtpërdrejtë në jetën e tij/saj

Standardi 12: Përkujdesja për fëmijën ofrohet në kushte të duhura jetësore

Standardi 13: Fëmijët me nevoja të veçanta marrin përkujdesje të duhur

Standardi 14: Fëmija/ i riu vazhdimisht përgatiten për të jetuar i pavarur



Standardi 7 Vendosja e fëmijës duhet të përshtatet me nevojat e tij/saj, situatën jetësore dhe ambientin shoqëror

Fëmija rritet në ambient përkrahës, mbrojtës, të dashur dhe gjithëpërfshirës. Fëmijës i mundësohet të rritet në familje të dashur që përmbush këto kritere të ambientit. Në vendosjen e re, fëmija ka mundësi të krijojë një marrëdhënie të qëndrueshme me kujdestarin dhe të mbajë kontakte me rrethin e tij/saj të mëparshëm shoqëror.

“Prindërit e mi strehues u udhëzuan me gjithçka që ishte e mirë dhe e dobishme për mua. Është me rëndësi për mua që ata më pranuan ashtu siç jam dhe respektuan mendimin, besimin, intimitetin tim dhe me lejuan të flas gjuhën time amtare”.

(Vajza nga Sllovenia, kodi 27.02.01)

A) Përgjegjësitë

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës

*Iniciojnë, gjejnë dhe caktojnë vendosjen më të mirë të mundur për fëmijën në pajtim me nevojat e saj/tij, situatën jetësore dhe ambientin e rrethin e mëparshëm shoqëror

Organizata e përkujdesjes

- Ofron llojet e përkujdesjes që përmbushin nevojat e fëmijës dhe kërkesat e Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës.
- Në bashkëpunim me Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës vlerëson nëse vendosja e ofruar përmbush nevojat e fëmijës, situatën jetësore dhe rrethin e mëparshëm shoqëror

Kujdestari

- Siguron që familja e re ti përshtatet nevojave të fëmijës, situatës së tij/saj jetësore dhe rrethit të mëparshëm shoqëror

B) Udhëzuesit

1. Fëmija dhe familja e tij biologjike informohen për mundësinë e përkujdesjes bazuar në familje

Nëse ka në dispozicion mundësi më të përshtatshme të përkujdesjes bazuar në familje, fëmija dhe familja e tij/saj biologjike informohen për këto mundësi.

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës inkurajojnë organizatat e përkujdesjes që të ofrojnë kujdes të bazuar në familje. Nëse fëmija është i pranuar në ndonjë institucion për trajtim, organizata e përkujdesjes duhet të gjej një mënyrë për të kombinuar këtë trajtim me përkujdesjen e bazuar në familje.



2. Fëmijës i jepet vendosja më e mirë e mundur

Shërbimi për mbrojtjen e fëmijës dhe organizata e përkujdesjes sigurojnë që vendosja e ardhme të ofroj ambient përkrahës, mbrojtës, të dashur dhe gjithëpërfshirës.

3. Vendosja i përshtatet nevojave të fëmijës, situatës jetësore dhe ambientit të mëparshëm shoqëror

Organizata e përkujdesjes bënë përpjekje të ndërgjegjshme që të sigurojë që vendosja t'i përshtatet nevojave të fëmijës, situatës jetësore dhe ambientit të mëparshëm shoqëror.

Merret parasysh largësia fizike ndërmjet bashkësisë së fëmijës dhe vendosjes së re.

4. Vendosja e re përkrah fëmijën në zhvillimin e ndjenjës së dashurisë dhe pranimi si anëtarë të familjes

Kujdestari i ofron fëmijës hapësirë personale dhe krijon një rreth në të cilin ai/ ajo mund të zhvilloi ndjenjën e dashurisë dhe të pranimi si anëtar i familjes.

5. Kualiteti i përkujdesjes shqyrtohet herë pas herë

Shërbimi për mbrojtjen e fëmijës dhe organizata e përkujdesjes herë pas herë e vlerësojnë kualitetin e përkujdesjes të ofruar.

C) Shenjat paralajmëruese

- Fëmijës nuk i ipet mundësi që të ketë kujdes të bazuar në familje.
- Nuk ka kontakte ndërmjet fëmijës, familjes së tij/saj biologjike dhe/ ose rrethit të mëparshëm shoqëror.
- Distanca fizike ndërmjet fëmijës, familjes së saj/tij biologjike dhe rrethit të mëparshëm shoqëror vështirësojnë kontaktet ndërmjet tyre.
- Fëmijës nuk i lejohet të ushtroj gjuhën e tij/saj amtare, fenë dhe kulturën.
- Caktimet nuk janë reale, të ndershme dhe /ose të detyrueshme.
- Fëmija ndihet që kujdesi ndaj tij nuk është përkrahës, mbrojtës, i dashur dhe gjithëpërfshirës.
- Fëmija nuk ndihet se ai/ajo mund të mbështetet në marrëdhënie të besueshme dhe të qëndrueshme me kujdestarin .
- Fëmija nuk ka intimitet.
- Kujdestari ndryshon vazhdimisht.
- Kujdestari nuk është i ndjeshëm ndaj gjendjes së fëmijës.



Standardi 8 Fëmija mban kontakte me familjen e tij/saj biologjike

Marrëdhënia e fëmijës me familjen e saj/tij biologjike inkurajohet, mbahet dhe përkrahet nëse kjo është në interesin më të mirë për fëmijën.

Kontakti është inkurajuar nga një punëtorë social.(...) Në të vërtetë, nëna strehuese, përveç që është kujdesur për fëmijën dhe e ka dërguar që ta shoh nënën biologjike, ajo po ashtu shfrytëzon mundësinë që gjatë këtyre kontakteve disa orësh t'ia mësoj nënës disa shkathtësi të përkujdesjes ndaj fëmijës. Marrëdhëniet e tyre pozitive janë të rëndësishme për fëmijën. Kjo ka qenë një ndihmë e madhe për atë që ta dijë se që nëna e tij dhe nëna e tij strehuese po ia kalojnë mirë

(Punëtori social nga Malta, kodi 19.08.04)

Lidhjet dhe marrëdhëniet ndërmjet fëmijës dhe prindërve të tij/saj biologjik duhet të përkrahen dhe (...) fëmija duhet të lejohet të vendos se çfarë lloji marrëdhënie dëshiron të ketë me prindërit e tij/saj biologjik

(Punëtori social nga Estonia, kodi 7.08.01)

A) Përgjegjësitë

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës ● Siguron që të mbahet kontakti ndërmjet fëmijës dhe familjes së tij/saj biologjike

Organizata e përkujdesjes

- Siguron dhe inkurajon kontaktet me familjen biologjike
- Përkrah kujdestarin.

Kujdestari

- Përkrah kontaktin ndërmjet fëmijës dhe familjes së tij/saj biologjike
- Bashkëpunon me familjen biologjike së fëmijës.

B) Udhëzuesit

1. Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës promovojnë kontaktin ndërmjet fëmijës dhe familjes së saj/tij biologjike

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës inkurajojnë, përkrahin dhe monitoron kontaktet ndërmjet fëmijës, kujdestarit dhe familjes biologjike. Po ashtu promovon bashkëpunimin ndërmjet tri palëve.

Shërbimi për mbrojtjen e fëmijës ofron këshilla për fëmijën, familjen e tij /saj biologjike dhe kujdestarin.



2. Organizata e përkujdesjes dhe kujdestarët përkrahin kontaktin ndërmjet fëmijës dhe familjes së tij biologjike
Organizata e përkujdesjes e trajnon dhe përkrah kujdestarin që të bashkëpunoj me familjen biologjike.

Kujdestari ndihmon fëmijën që të familjarizohet me ngjarjen e tij/saj jetësore dhe inkurajon atë që të mbaj kontakte me familjen e tij/saj biologjike dhe të ruaj prapavijën sociale, fetare dhe kulturore.

Kujdestari kohë pas kohe e informon familjen biologjike për zhvillimin e fëmijës.

3. Familja biologjike është e përfshirë në jetën e fëmijës

Organizata e përkujdesjes dhe familja biologjike në mënyrë të qartë i përcaktojnë rolet, të drejtat dhe përgjegjësitë lidhur me zhvillimin e fëmijës në pajtim me ligjet vendore.

Organizata e përkujdesjes përkrah familjen biologjike në kuptimin e situatës së fëmijës dhe e inkurajon familjen ti ndihmojë atij/asaj.

4. Kohë pas kohe vlerësohet prania dhe kualiteti i kontakteve

Prania dhe kualiteti i kontaktit ndërmjet fëmijës dhe familjes së tij/saj duhet të vlerësohet rregullisht. Kontaktet bëhen në pajtim me planin e përkujdesjes individuale dhe/ose ndonjë marrëveshje të bërë lidhur me këtë çështje.

C) Shenjat paralajmëruese

- Edhe pse do të jetë në interesin më të mirë të fëmijës, nuk ka kontakte ndërmjet fëmijës dhe familjes së saj/tij biologjike.
- Familja biologjike vepron në kundërshtim me interesin më të mirë të fëmijës
- Nuk përkrahet kontakti ndërmjet fëmijës dhe familjes së tij/saj biologjike.
- Nuk janë të bazuara arsyet për mospërkrahje të kontaktit ndërmjet fëmijës dhe familjes së tij/saj biologjike



Standardi 9 Kujdestarët janë të kualifikuar dhe kanë kushte adekuate për punë

Në tërësi kujdestarët vlerësohen, zgjidhen dhe trajnohen para se të marrin përgjegjësinë e përkujdesjes ndaj fëmijës. Ata vazhdimisht trajnohen dhe marrin përkrahje profesionale që të sigurojnë zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës.

“Trajnimi i prindërve strehues ishte i shkëlqyeshëm. Unë dhe bashkëshorti im kemi strehuar fëmijë edhe më parë por ne u kuptuam sa pak ne kishim ditur (...)Tani jam shumë e sigurt që askush nuk duhet të lejohet që të strehoj ndonjë fëmijë përderisa ata nuk e përfundojnë trajnimin për prindërit strehues”.

(Kujdestarja na Islanda, kodi 13.06.01)

A) Përgjegjësitë

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës	<ul style="list-style-type: none"> ●Përcaktojnë gjendjen e kualifikimit të kujdestarit ●Sigurojnë që të gjithë kujdestarët së paku të përmbushin profilet e kualifikimeve
Organizata e përkujdesjes	<ul style="list-style-type: none"> ●Siguron që të gjithë kujdestarët së paku përmbushin kualifikimet e përcaktuara nga shërbimet për mbrojtjen e fëmijës. ●Siguron trajnime dhe përkrahje të vazhdueshme
Kujdestari	<ul style="list-style-type: none"> ●Merrë pjesë në trajnimet e vazhdueshme.

B) Udhëzuesit

1. Kujdestarët zgjidhen dhe trajnohen në pajtim me profilin e kualifikimit të pranuar

Shërbimet për përkujdesjen e fëmijës sigurojnë që fëmija të vendoset në organizatën e përkujdesjes që në mënyrë profesionale trajnon dhe përkrah kujdestarët në pajtim me profilin e kualifikimit.

Profili i kualifikimit të kujdestarit duhet të përfshijë aftësinë e kujdestarit që të bazoj veprimet e veta në KDF të KB-së, kërkesat për mbrojtjen e fëmijës (kodi i mirësjelljes) dhe njohurit mbi zhvillimin e fëmijës. Ata trajnohen që të përdorin gjuhën e duhur me mënyrën e të menduarit të fëmijës/të riut. Ata krijojnë marrëdhënie të ngushtë me fëmijën/ të riun, kanë aftësi të mira dëgjimi dhe janë të kuptueshëm, të durueshëm dhe të ndjeshëm.

Organizata e përkujdesjes siguron që kujdestari të vlerësohet, zgjedhet, trajnohet, përkrahet dhe monitorohet tërësisht.



2. Kujdestari ka qasje në trajnim dhe përkrahje profesionale

Kujdestarit i ofrohet përkrahje dhe trajnime profesionale në pajtim me nevojat dhe kërkesat e tij/saj. Në përgjithësi, organizata e përkujdesjes i ofron kujdestarit mundësinë që të ndajë përvojat dhe praktikatat, të marrë pjesë në takime dhe konferenca relevante si dhe të trajnohet, këshillohet dhe mbikqyret.

3. Kujdestarët kanë kushte adekuate për punë

Kujdestari përkrahet përmes kushteve adekuate për punë. Ai/ ajo jeton në një vend që ofron infrastrukturë adekuate. Kujdestari mund të mbështetet në burimet njerëzore dhe financiare që janë të nevojshme për të përmbushur në mënyrë të duhur përgjegjësitë e saj/tij.

4. Inkurajohet formimi i rrjetit të shkëmbimeve

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës dhe/ose organizatat e përkujdesjes inkurajojnë formimin e rrjeteve formale dhe jo formale për të dhënë kujdestarëve mundësi që të ndajnë përvojat dhe praktikatat e mira.

C) Shenjat paralajmëruese

- Nuk janë të përcaktuara kërkesat minimale lidhur me profilin e kualifikimit të kujdestarit.
- Kujdestarët nuk vlerësohen dhe përzgjidhen me kujdes.
- Kujdestarët nuk kanë qasje në trajnime adekuate profesionale dhe /ose përkrahje.
- Kujdestarët nuk pranojnë përkrahje dhe/ose trajnime profesionale.
- Nuk inkurajohen trajnimet dhe përkrahja.



Standardi 10 Marrëdhënia e kujdestarit me fëmijën bazohet në mirëkuptim dhe respekt

Kujdestari i kushton vëmendje individuale fëmijës dhe bënë përpjekje që të ngritë besimin dhe mirëkuptimin tek ai/ajo. Kujdestari gjithmonë komunikon me fëmijën në mënyrë të hapur,të ndershme dhe me respekt.

“Ata(prindërit strehues) e morën në përkujdesje atë në mënyrë të natyrshme. Ata ishin të durueshëm dhe nuk u dorëzuan. Ata ishin të hapur dhe bisedonin për gjëra të ndryshme në mënyrë të këndshme. Ata bisedonin për gjithçka, përfshirë edhe për gjërat që ishin të vështira. Ata po ashtu i treguan atij se e donin atë dhe e përqaфонin shumë”

(Tregimi për një djalë nga Suedia, kodi 29.01.01)

“ Unë jam shumë mirënjohëse ndaj prindërve të mi strehues. Ata më morën në familjen e tyre kur unë isha 14 vjeçe. Ata mi mësuuan të gjitha për familjen: dashurinë, besnikërinë dhe respektin ndaj njerëzve. Ata më mësuuan si të gatuj. Ata më mësuuan që të mos frikohem për të shprehë ndjenjat e mia dhe ta them atë që e kam në mendje. Ata më donin dhe unë këtë e mësova nga ata. Unë nuk isha mësuar me ndjeshmëri dhe në fillim kjo më turpëronte shumë. Isha shumë e turpshme. Unë e çmoj faktin se nëna ime strehuese nuk më ka rrahur asnjëherë. Tashmë unë kisha përjetuar shumë. Tmerret e fëmijërisë time ishin sikur hije të zeza që më ndoqën për një kohë të gjatë”.

(Vajza nga Lituania, kodi 16.02.01)

A) Përgjegjësitë

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës

- I ofrojnë organizatës së përkujdesjes dhe kujdestarit të gjitha informatat lidhur me rrethanat e fëmijës
- Sigurojnë bashkëpunim në mes të familjes biologjike dhe kujdestarit

Organizata e përkujdesjes

- Përkrah kujdestarin në themelimin dhe ruajtjen e një marrëdhënie të qëndrueshme me fëmijën.
- Siguron që kujdestari të ketë aftësitë e duhura për të ngritur një marrëdhënie të mirë me fëmijën

Kujdestari

- Ofron fëmijës mundësi që të ngritë besimin.



B) Udhëzuesit

1. Kujdestari informohet, trajnohet dhe përkrahet

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës e informojnë organizatën e përkujdesjes dhe kujdestarin për rrethanat e fëmijës me qëllim që ata të kenë mundësi të drejtohen fëmijës në mënyrë të duhur.

Organizata e përkujdesjes trajnon dhe përkrah kujdestarin që të ngritë dhe të mbajë marrëdhënie të qëndrueshme me fëmijën.

2. Kujdestari i ofron fëmijës mundësi që të krijoj marrëdhënie të qëndrueshme

Kujdestari gjithmonë merr parasysh rrethanat, nevojat individuale, mundësitë dhe nivelin e të kuptuarit të fëmijës.

3. Kujdestari i çaset secilit fëmijë individualisht

Kujdestari gjithnjë merr parasysh prapavijën e fëmijës, nevojat e tij/saj individuale, aftësitë dhe nivelin e të kuptuarit.

C) Shenjat paralajmëruese

- Mungon respekti i mirëkuptimit në marrëdhënien ndërmjet kujdestarit dhe fëmijës.
- Mungojnë informatat për fëmijën.
- Fëmija mban distancë nga kujdestari i tij/saj.
- Kujdestarët ndryshojnë shumë



Standardi 11 Fëmija nxitet të marrë pjesë aktive në marrjen e vendimeve që ndikojnë drejtpërdrejtë në jetën e tij/saj

Fëmija pranohet si një ekspert i jetës së tij/saj. Fëmija informohet, dëgjohe dhe kuptohet seriozisht dhe fleksibiliteti i tij/ saj pranohet si një potencial i fortë. Fëmija inkurajohet që të shpreh ndjenjat dhe përvojat e tij/saj.

“ Ishte thelbësore për mua përkrahja që kam marrë nga shumë kujdestarë(...) është me rëndësi që kujdestari të thotë që ti je i rëndësishëm, që ti mund të bëhesh” dikush në jetën tënde” (...) Unë mendoj që edukatorët për mua janë njerëzit që më vlerësuan dhe më përkrahën më së shumti(..) ata gjithmonë më përkrahën (në zgjedhjen e diplomës së universitetit në arsimimin shoqëror). Asnjëherë nuk më kundërshtuan “

.(Vajza nga Spanja, kodi 28.02.01)

A) Përgjegjësitë

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës

- Monitorojnë pjesëmarrjen e fëmijës në të gjitha vendimet që ndikojnë drejtpërdrejtë në jetën e tij/saj

Organizata e përkujdesjes

- Siguron që pjesëmarrja është pjesë përbërëse në procesin e përkujdesjes.

Kujdestari

- I jep të drejtë fëmijës që të marr vendime që ndikojnë drejtpërsëdrejti në jetën e tij/saj.
- Në mënyrë aktive përkrah pjesëmarrjen e fëmijës.

B) Udhëzuesit

1. Organizata e përkujdesjes përkrah pjesëmarrjen e fëmijës

Organizata e përkujdesjes:

- siguron burime për të promovuar pjesëmarrjen e fëmijës
- zhvillon dhe zbaton mjete të ndryshme që sigurojnë pjesëmarrjen aktive të fëmijës
- promovon qëndrim pjesëmarrës përmes përfshirjes së punonjësve
- siguron që të gjitha palët e përfshira në rastin e fëmijës janë të trajnuara në mënyrë profesionale me qëllim që të përkrahin pjesëmarrjen e fëmijës

2. Kujdestari përkrah pjesëmarrjen aktive të fëmijës

Kujdestari:

- informon fëmijën për të drejtat e tij/saj dhe të gjitha çështjet relevante lidhur me jetën e tij/saj
- e dëgjon, inkurajon dhe përkrahë në marrjen e vendimeve lidhur me jetën e tij/saj



3. Kujdestari përkrah dhe beson në aftësitë dhe mundësitë e fëmijës

Kujdestari:

- identifikon mundësitë e fëmijës dhe inkurajon atë që ti shfrytëzoj dhe zhvilloj ato;
- respekton individualitetin e fëmijës, merr parasysh mendimin e tij/saj dhe përkrah aspiratat e tij/saj për të jetuar i pavarur
- vërteton rëndësinë e fëmijës duke treguar interesim për nevojat e tij/saj

C) Shenjat paralajmëruese

- Mjetet pjesëmarrëse nuk janë të zhvilluara dhe / ose të zbatuara.
- Fëmija nuk merr pjesë në vendimmarrje lidhur me jetën e tij/saj.
- Fëmija ndihet që mundësitë e tij/saj as nuk perceptohen e as nuk përkrahen.
- Fëmija ndihet që nuk po dëgjohet dhe /ose kuptohet.
- Fëmija nuk ka informata të mjaftueshme lidhur me çështjet relevante për të drejtat e tij/saj.

Standardi 12 Përkujdesja për fëmijën ofrohet në kushte të duhura jetësore

Infrastruktura dhe standardet jetësore të organizatës së përkujdesjes dhe/ose kujdestari plotësojnë nevojat e fëmijës lidhur me komoditetin, kushtet e shëndosha jetësore si dhe qasje të lirë në arsimim dhe bashkësi.

“Nuk më kujtohet saktësisht se kur për herë të parë jam ndier mirë në familjen time strehuese. Ndoshta kur kam bërë dush. Pastërtia është shumë me rëndësi për mua. E dini, fjetja në ora 7:30, e bartur me peshqir, pjata me fruta, ushqimi gjithmonë në kohë të njëjtë, gjithçka e organizuar. Madje edhe gjërat e vogla janë të rëndësishme.”

(Vajza nga Irlanda, kodi 13.02.06)

“Unë përdori(..) të dhënat për të vlerësuar zhvillimin e fëmijëve që janë nën përkujdesje në të gjitha llojet e përkujdesjes publike. Plotësimi i formularëve në mënyrë të rregullt lehtëson planifikimin, vendimmarrjen, revizionin dhe monitorimin lidhur me përkujdesjen dhe zhvillimin e fëmijës(...)Për shembull(një herë) një djalë në institucion ishte diagnostikuar me alergji në qumësht(..) kjo informatë ishte me rëndësi për prindërit strehues.”

(Punëtori social nga Hungaria, kodi 12.08.01)

A) Përgjegjësitë

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës

- Garantojnë vendosje që ofron kushte adekuate jetësore dhe që plotësojnë nevojat e fëmijës

Organizata e përkujdesjes

- Siguron ambient të rehatshëm, të sigurt, të shëndoshë dhe stabil për fëmijën

Kujdestari

- Ofron shtëpi të rehatshme, të sigurt, të shëndoshë dhe stabile.

B) Udhëzuesit

1. Fëmija mbahet nën përkujdesje në kushte të duhura jetësore

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës monitorojnë përmbushjen minimale të kërkesave lidhur me kushtet jetësore të fëmijës; kjo përfshinë rehatinë, sigurinë, kushtet e shëndosha jetësore si dhe qasje të lirë në arsimim dhe komunitet. Veç kësaj, sigurojnë vendosje që plotëson këto kërkesa minimale.



2. Organizata e përkujdesjes përmbush kërkesat minimale

Organizata e përkujdesjes garanton kualitetin e përkujdesjes të saj përmes një deklarate të shkruar. Ky kualitet ofron vendosje që përmbush kërkesat e detyrueshme minimale.

Kjo deklaratë është në dispozicion për të gjithë.

3. Sigurohet mirëqenia e fëmijës dhe kushtet e duhura jetësore

Kujdestari ndjek kërkesat e detyrueshme minimale me qëllim që të garantoj rehati, siguri kushte të shëndosha jetësore si dhe qasje të hapur në arsimim dhe komunitet.

C) Shenjat paralajmëruese

- Nuk ka kërkesa të detyrueshme minimale për kushtet jetësore të fëmijës.
- Vendosja e fëmijës nuk plotëson kërkesat e detyrueshme minimale.
- Organizata e përkujdesjes nuk ka deklaratë të shkruar dhe/ose nuk e vë atë në dispozicion.

Standardi 13 Fëmijët me nevoja të veçanta marrin përkujdesjen e duhur

Në mënyrë specifike dhe të vazhdueshme kujdestarët trajnohen dhe përkrahen për të përmbushur nevojat e veçanta të fëmijëve nën përkujdesjen e tyre.

“Ajo që na ka ndihmuar(...)në punën me fëmijët ishte arsimimi, aftësitë dhe përvoja e nënës strehuese(...)Psikologu që punonte të shtëpinë e fëmijëve (..) i informoj ata për anamnezën dhe gjendjen e tij të tanishme(..) ishte e domosdoshme që çdo ditë atij ti kushtohet kohë për të ia mësuar zakonet dhe shkathtësitë themelore, për ta ushtruar se si të vishet, për të ia sqaruar konceptet themelore, për ta mësuar se si të flas në fjali, të njoh format dhe ngjyrat. Ishte e domosdoshme që ai të mësohej të luaj.”

(Kujdestari nga Republika Çeke, kodi 5.06.05)

“Falënderoj terapistin e të folurit për bashkëpunim që mësoj kujdestarin strehues të ndihmoj djalin të tejkaloj problemet në komunikimin e tyre të shkaktuar nga një defekt në dëgjim.”

(Kujdestar nga Republika Çeke, kodi 5.06.0)

A) Përgjegjësitë

- | | |
|-----------------------------------|--|
| Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës | ● Sigurojnë që fëmija me nevoja të veçanta të vendoset në mënyrë të duhur. |
| Organizata e përkujdesjes | ● Siguron që fëmija me nevoja të veçanta të merr përkujdesjen e duhur
● Siguron që fëmija me nevoja të veçanta merr tretman nëse është e nevojshme. |
| Kujdestari | ● Ofron përkujdesjen e duhur për fëmijën me nevoja të veçanta.
● Siguron që fëmija me nevoja të veçanta të marr trajtim profesional nëse kjo është e nevojshme. |

B) Udhëzuesit

1. Vendosja e fëmijës me nevoja të veçanta përgatitet në tërësi para se të pranohet

Shërbimi për mbrojtjen e fëmijës ia ofron organizatës së përkujdesjes dhe kujdestarit të gjitha informatat e nevojshme për tu përballur me nevojat e veçanta të fëmijës.



2. Fëmijëve me nevoja të veçanta u ofrohet kujdes i duhur

Kujdestari përkrah dhe inkurajon zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës në pajtim me mundësitë individuale të fëmijës. Ai/ajo siguron përfshirjen dhe pjesëmarrjen e fëmijës.

3. Kujdestarët e fëmijëve me nevoja të veçanta marrin trajnime dhe përkrahje shtesë të specializuar

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës dhe/ose organizata e përkujdesjes siguron përkrahje dhe trajnime të vazhdueshme për kujdestarin me qëllim të ta kualifikoj atë që të përmbush nevojat e veçanta të fëmijës.

4. Kujdestari bashkëpunon me specialistët

Kujdestari kërkon përkrahje dhe bashkëpunon me specialistët dhe institucionet kompetente me qëllim që të përmbush nevojat e veçanta të fëmijës.

C) Shenjat paralajmëruese

- Nuk ekziston mënyra e duhur e përkujdesjes për fëmijën me nevoja të veçanta.
- Gjatë vendosjes nuk merren parasysh nevojat e veçanta të fëmijës.
- Fëmijës me nevoja të veçanta nuk i jepet kujdesi i duhur.
- Kujdestarit nuk i ofrohen informata, trajnime adekuate dhe/ose përkrahje që të kujdeset për fëmijën me nevoja të veçanta.
- Bashkëpunimi ndërmjet kujdestarit dhe specialistit nuk është i duhur ose nuk ekziston.
- Specialistët që e trajtojnë fëmijën nuk kanë kualifikimet e nevojshme për të përmbushur/ trajtuar fëmijën me nevoja të veçanta

Standardi 14 Fëmija/i riu vazhdimisht përgatitet për jetë të pavarur

Fëmija/ i riu përkrahet në krijimin e të ardhmes së tij/saj që të bëhen të sigurt në vetvete, të pavarur dhe anëtarë pjesëmarrës të shoqërisë. Ai / ajo ka qasje në arsimim dhe i jepet mundësi që të fitojë shkathtësi për jetë dhe të përvetësoj vlera.

Fëmija/ i riu përkrahet në zhvillimin e vetëbesimit. Kjo i lejon atij/asaj që të ndihet i fortë dhe i sigurt dhe të përballet me vështirësitë.

“Detyra e nënës është që të ngritë fëmijët në atë mënyrë që ata ta shohin vetveten si njerëz që kanë vlera, dinjitet, mundësi dhe forcë që të mbijetojnë dhimbjen në mënyrë që të jetojnë jetët e tyre.”

(Kujdestari nga Lituania, kodi 17.08.02)

“Duhet theksuar prezencën e edukatorit dhe duhet kërkuar nga ai/ajo që të ndihmoj(...). Shtëpiaku në organizatën e përkujdesjes duhet të jetë si edukator dhe duhet të mundësohet që nga ai të mësohet zdrukthëtaria; Po ashtu, do të jetë e dobishme të mësohet se si të riparohet vetura dhe të meremetohet banesa(..) nëse ia dilni mbanë që të punoni diku derisa jeni në shtëpinë për të rinjtë(...) juve nuk do të ju mungoj asgjë(..) ata që bëjnë më shumë marrin më shumë; ata që bëjnë më pak marrin më pak”

(Djali nga Estoni, kodi 7.01.02)

A) Përgjegjësitë

Shërbimi për mbrojtjen e fëmijës

- Monitoron zhvillimin e fëmijës/ të riut lidhur me përgatitjen për jetë të pavarur siç është pajtuar në planin e përkujdesjes
- Siguron që fëmija/i riu të ketë qasje në arsimim optimal

Organizata e përkujdesjes

- Siguron kushtet dhe programet e duhura për përkrahjen e fëmijës/ të riut që të bëhet i pavarur

Kujdestari

- Përkrah fëmijën/ të riun të bëhet i pavarur.



B) Udhëzuesit

1. Kujdestari ofron përkrahje dhe trajnime të individualizuara

Kujdestari siguron që fëmija/ i riu trajnohet dhe përkrahet në zhvillimin e vetëbesimit në pajtim me nevojat e paraqitura në planin e përkujdesjes. Së pari, kujdestari fokusohet në pikat si në vijim:

- Fëmija/ i riu inkurajohet që të marrë përgjegjësinë e përditshme. Në pajtim me nivelin e tij/saj të të kuptuarit, fëmija / i riu përkrahet që të kujdeset për veten e tij/saj dhe si të veproj me të hollat, çështje ligjore, sigurimet dhe çështje tjera praktike;
- Fëmija/ i riu përkrahet që të integrohet në rrjetin shoqëror dhe të ruaj kontaktet me njerëzit në këtë rrjet;
- Kujdestari e hulumton interesimin e fëmijës/ të riut dhe planifikon aktivitetet që përkrahin shkathësitë për jetë dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive të tij/saj

2. Përgatitja për jetë të pavarur organizohet si një proces i pavarur

Me përkrahje të organizatës së përkujdesjes, kujdestari e përgatit fëmijën/ të riun për jetë të pavarur. Ky proces bazohet në planin e përkujdesjes individuale.

Plani i përkujdesjes e konsideron përgatitjen e fëmijës për jetë të pavarur si një proces të vazhdueshëm. Ky plan merr parasysh kushtet dhe mundësitë e duhura dhe /ose programet që të përkrahet ai/ ajo për tu bërë i pavarur.

3. Fëmijës/ të riut i ofrohen programet/ mundësitë e vet-zhvillimit

Organizata e përkujdesjes dhe kujdestari krijojnë mundësi dhe/ose programe në të cilat fëmija/ i riu trajnohet që të marrë përgjegjësitë, të integroj vlerat dhe normat dhe të zhvilloj aftësitë për jetë.

Fëmija/ i riu merr pjesë në programet/ mundësitë e zhvillimit, zbatimit dhe vlerësimit të vet-zhvillimit.

4. Fëmija/ i riu ka qasje në nivelin më të mirë të arsimimit

Fëmija/ i riu ka qasje dhe inkurajohet të përfitoj nga forma më e mirë e edukimit në pajtim me potencialin e tij/saj dhe interesin e vet.

Fëmija/ i riu inkurajohet që sipas interesit të tij/saj individual të ndaj aktivitetet në mënyrë qarkore dhe ekstra qarkore.

C) Shenjat paralajmëruese

- Në planin e përkujdesjes nuk merret parasysh përgatitja për jetë të pavarur.
- Nuk ka në dispozicion programe /mundësi për vet-zhvillim.
- Fëmijës/ të riut i mohohet mundësia që të shfrytëzoj mundësitë/programet e vet-zhvillimit.
- Fëmija/ i riu ndien që nuk është i përkrahur dhe i përgatitur mirë për jetë të pavarur.
- Fëmija/ i riu nuk është i integruar në rrjetin shoqëror.
- Fëmija / i riu nuk inkurajohet për arsimim.
- Fëmija/ i riu nuk e shpenzon kohën e tij/ saj të lirë në mënyrë produktive.
- Fëmija/ i riu nuk dëgjohet



Tema e Standardit 3

Procesi i largimit nga përkujdesja

Termi “ procesi i largimit nga përkujdesja” i referohet procesit në të cilin fëmija/ i riu bëhet i pavarur, kthehet tek familja e tij/saj biologjike ose kalon në një vend tjetër. Ky proces përfshinë vendimin, procesin e largimit dhe përkrahjen pas përkujdesjes.

Kjo temë e standardit përfshinë standardet në vijim:

Standardi 15: Procesi i largimit nga përkujdesja planifikohet dhe zbatohet me kujdes të veçantë.

Standardi 16: Komunikimi në procesin e largimit nga përkujdesja bëhet në mënyrë të duhur dhe të dobishme

Standardi 17: Fëmija/ i riu nxitet të marrë pjesë në procesin e largimit nga përkujdesja.

Standardi 18: Sigurohet përcjellja, përkrahja e vazhdueshme dhe mundësitë për kontaktim

Standardi 15 Procesi i largimit nga përkujdesja planifikohet dhe zbatohet me kujdes të veçantë

Procesi i largimit nga përkujdesja është një fazë e rëndësishme në përkujdesjen e fëmijës jashtë shtëpisë dhe planifikohet dhe zbatohet me kujdes të veçantë.

Fëmija/ i riu njihet si ekspert lidhur me kualitetin e përkujdesjes ndaj tij/saj. Reagimi i tij/saj është thelbësor për zhvillimin e mëtutjeshëm të cilësisë së sistemit të përkujdesjes dhe të llojeve përkatëse të përkujdesjes.

“Këshilltari inicioi takime të rregullta të përbashkëta me të gjitha palët e përfshira, në këtë rast (gjyshërit dhe babai) fëmijët dhe një përfaqësues nga Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës. Në një nga takimet e planifikuara, ata të gjithë vendosën që motra e madhe duhet të qëndroj në organizatën e përkujdesjes dhe dy fëmijët e tjerë duhet të kalojnë më tepër kohë me familjen. Të gjitha palët e përfshira ishin të kënaqur me vendimin”

(Punëtori social nga Bullgaria, kodi 3.08.01)

A) Përgjegjësitë

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës	<ul style="list-style-type: none">● Monitoron dhe përkrah planifikimin dhe zbatimin e procesit të largimit nga përkujdesja● Koordinon bashkëpunimin ndërmjet të gjitha palëve të përfshira
Organizata e përkujdesjes	<ul style="list-style-type: none">● Siguron që procesi i largimit nga përkujdesja të planifikohet dhe zbatohet në pajtim me planin e përkujdesjes● Gjatë tërë procesit fëmija/ i riu shoqërohen me profesionalizëm dhe ndjeshmëri● Bashkëpunon me familjen biologjike
Kujdestari	<ul style="list-style-type: none">● Planifikon procesin e largimit nga përkujdesja së bashku me palët e përfshira● Zbaton procesin e largimit nga përkujdesja sipas planit të përkujdesjes● Bashkëpunon me familjen biologjike

B) Udhëzuesit

1. Procesi i largimit nga përkujdesja planifikohet dhe zbatohet me kujdes të veçantë

Duke u bazuar në planin e përkujdesjes, kujdestari së bashku me fëmijën/ të riun planifikon dhe zbaton procesin e largimit nga përkujdesja. Ky proces zbatohet në mënyrë graduale që të jetë në interesin më të mirë të fëmijës.



Fëmija/ i riu shpreh mendimin në përcaktimin se deri në çfarë mase duhet familja e tij/saj të marrë pjesë në planifikimin dhe zbatimin e procesit të largimit nga përkujdesja.

Nëse është e nevojshme, kujdestari konsultohet me një ekip multi-profesional.

2. Fëmija/ i riu njihet si një ekspert lidhur me kualitetin e përkujdesjes ndaj tij/saj

Kujdestari kërkon që fëmija/ i riu të vlerësojë kualitetin e përkujdesjes. Më pas, kujdestari këtë reagim e përcjell tek organizata e përkujdesjes me qëllim që organizata mund ta marr atë parasysh për zhvillimin e mëtejshëm të kualitetit të sistemit të përkujdesjes dhe llojeve përkatëse të përkujdesjes.

3. Procesi i largimi nga përkujdesja bazohet në planin e përkujdesjes individual

Plani i përkujdesjes përcakton statusin zhvillimor të fëmijës/ të riut gjatë procesit të largimit nga përkujdesja. Plani i përkujdesjes dhe zbatimi i tij vlerësohen rregullisht.

Po ashtu, plani i përkujdesjes merr në konsideratë jetën e ardhme të fëmijës/ të riut lidhur me përcaktimin e direktivave për përkujdesjen e mëvonshëm.

4. Përgatitet plotësisht kthimi në familjen biologjike ose kalimi në ndonjë vend tjetër. Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, kujdestari i tanishëm dhe i ardhshëm dhe familja biologjike duhet të bashkëpunojnë nëse fëmija / i riu kthehet tek familja e tij/saj ose largohet në ndonjë vend tjetër.

Fëmija/ i riu në mënyrë aktive merr pjesë në përgatitjet dhe procesin e vendimarrjes sipas nivelit të saj/ tij të të kuptuarit.

5. Caktohet një mbrëmje lamtumirëse për fëmijën/ të riun

Organizohet një mbrëmje lamtumirëse për fëmijën/ të riun për të shënuar fillimin e një faze të re të jetës së saj/ tij. Kjo është bërë në pajtim me traditat e përbashkëta të mjedisit të fëmijës me qëllim që të përmbushen dëshirat e fëmijës/ të riut.

6. Fëmija/ i riu edhe pas largimit nga përkujdesja jashtë shtëpisë ka të drejtë për përkrahje dhe këshillime

Shërbimet për përkujdesjen e fëmijës dhe organizata e përkujdesjes ofrojnë përkrahje dhe këshilla pas largimit nga përkujdesja .

C) Shenjat Paralajmëruese

- Procesi i largimit nga përkujdesja nuk është planifikuar dhe/ose zbatuar plotësisht.
- Procesi i largimit nga përkujdesja nuk është marr parasysh në planin e përkujdesjes.
- Palët e përfshira nuk pajtohen mbi planin e largimit nga përkujdesja
- Fëmija/ i riu nuk ndihet i përfshirë në procesin e largimit nga përkujdesja
- Fëmija/ i riu dhe /ose familja e tij/saj biologjike nuk marrin pjesë në planifikimin dhe zbatimin e procesit të largimit nga përkujdesja.
- Nuk ka interesim në ekspertizën e fëmijës/ të riut lidhur me kualitetin e përkujdesjes ndaj tij/saj.
- Nuk ka vlerësim të përkujdesjes jashtë shtëpisë.
- Procesi i largimit nga përkujdesja nuk plotëson nevojat individuale të fëmijës/ të riut.
- Përkrahja pas përkujdesjes është jo adekuate ose nuk ka fare përkrahje.
- Fëmija/ i riu nuk ka mundësi për përshëndetje lamtumirëse

Standardi 16 Komunikimi në procesin e largimit nga përkujdesja bëhet në mënyrë të duhur dhe të dobishme

Të gjitha palëve të përfshira në procesin e largimit nga përkujdesja ju ofrohen të gjitha informatat relevante në pajtim me rolin e tyre në proces. Në të njëjtën kohë, fëmija/ i riu dhe familja e saj/ tij biologjike kanë të drejtë në intimitet dhe siguri.

Të gjitha informatat komunikohen në mënyrë të duhur dhe të kuptueshme për fëmijën/ të riun dhe familjen tij/saj biologjike.

“Fakti që ajo do të vendoset vetëm në shtëpinë e të rinjve dhe do të lë pas vëllezërit/ motrat e saj e bënë atë të shqetësohet dhe të mërzitët. (...)Një ditë vajza vizitoj shtëpinë e të rinjve që të familjarizohet me rrethin e ri. Atje ajo takoj një vajzë nga institucioni (...) që i tregojë asaj se aty kishte rehati, ajo ka intimitetin e vet dhe hapësirën e saj të lirë(..) Vajzës i pëlqeu atë që e pa dhe dëgjoj në shtëpinë për të rinj. Papritmas të gjitha shqetësimet e saj u larguan. Tan,i ajo është shumë më optimiste dhe ka ëndrra të reja për të ardhëm e saj.”

(Tregimi për një vajzë nga Qipro veriore, kodi 21.02.05)

A) Përgjegjësitë

- | | |
|-----------------------------------|---|
| Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës | <ul style="list-style-type: none">●Sigurojnë që të gjitha palët e përfshira marrin dhe kuptojnë informatat e nevojshme për planifikimin dhe zbatimin e procesit të largimit nga përkujdesja●Sigurojnë që të gjitha informatat të trajtohen me konfidencialitet |
| Organizata e përkujdesjes | <ul style="list-style-type: none">●Siguron që kujdestari të komunikojë me fëmijën/ të riun në mënyrë të duhur |
| Kujdestari | <ul style="list-style-type: none">●Siguron që fëmija/ i riu pranon dhe kupton informatat relevante lidhur me procesin e largimit nga përkujdesja●Komunikon me fëmijën/ të riun në atë mënyrë që i bënë ata të ndihen të lehtësuar gjatë procesit të largimit nga përkujdesja●Bashkëpunon me familjen biologjike |

B) Udhëzuesit

1. Informatat relevante menaxhohen në mënyrë profesionale

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, organizata e përkujdesjes dhe kujdestari e pranojnë rëndësinë e ofrimit të të gjitha informatave relevante për fëmijën/ të riun dhe familjen e tij/saj biologjike.

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës në mënyrë profesionale menaxhojnë të gjitha informatat relevante: Sigurojnë konfidencialitetin, dokumentacionin e duhur dhe qasjen për përfshirje të palëve.



2. Fëmija/i riu informohet në mënyrë të duhur për procesin e largimit nga përkujdesja

Kujdestari siguron që fëmija/ i riu është i informuar dhe kupton të gjitha informatat relevante lidhur me procesin e largimit nga përkujdesja. Në veçanti, fëmija/ i riu informohet për mundësitë e ndryshme dhe aspektet e jetës së ardhme në të cilën ai / aji ose bëhet e pavarur, kthehet në familjen biologjike ose kalon në ndonjë vend tjetër.

3. Merren parasysh një sërë kërkesash në sigurimin e komunikimit të duhur

Të gjitha palët e përfshira që përkrahin fëmijën/ të riun gjatë procesit të largimit nga përkujdesja përmbushin së paku këto kritere:

- Ata janë të aftësuar të përdorin gjuhën në mënyrën e të menduarit të fëmijës
- Ata krijojnë marrëdhënie të ngushtë me fëmijën/ të riun kanë aftësi të mira dëgjimi dhe janë të kuptueshëm, të ndjeshëm dhe të durueshëm me qëllim që fëmija/ i riu të ndihen të lirë;
- Ata krijojnë një ambient miqësor dhe të përshtatshëm të komunikimit.

4. Fëmija, familja biologjike, kujdestari, organizata e përkujdesjes dhe Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës punojnë së bashku. Bashkëpunimi ndërmjet palëve të përfshira në përkrahjen e fëmijës/ të riut gjatë procesit të largimit nga përkujdesja forcohet me shkëmbimin e informatave relevante, komunikim të duhur dhe besim të dyanshëm. Ata:

- pajtohen me legjislacionin, rregulloret dhe standardet CPF;
- përfshijnë këtë standard (16) në udhëzimet dhe metodat e punës së Shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës, organizatës së përkujdesjes dhe kujdestarit;
- janë pjesë të rrjetit për përkujdesjen e fëmijës,

C) Shenjat Paralajmëruese

- Fëmija/ i riu ndihet që nuk po kuptohet.
- Shkelet intimiteti i fëmijës/ të riut.
- Fëmija/ i riu dhe /ose palët e përfshira relevante nuk kanë qasje ose nuk e kuptojnë informatën e ofruar.
- Nuk ka shkëmbin të informatave.
- Fëmija/ i riu ndien mungesë të komunikimit me kujdestarin e tij/saj
- Fëmija/ i riu ndien mungesë të komunikimit me familjen e tij/saj biologjike dhe/ose me rrethin e tij shoqëror

Standardi 17 Fëmija/i riu nxitet të marrë pjesë në procesin e largimit nga përkujdesja

Procesi i largimit nga përkujdesja bazohet në planin e përkujdesjes individual. Fëmijës/ të i riut i jepet e drejta të shpreh mendimin dhe preferencat për situatën e tanishme dhe jetën e ardhme. Ai/ ajo merr pjesë në planifikimin dhe zbatimin e procesit të largimit nga përkujdesja.

“Pjesëmarrja e vajzës në planifikim e procesit i jep asaj mundësi ta shoh për vetveten se si është marrë vendimi, të di edhe sa gjatë ajo do të qëndroj në institucion dhe ta parashikoj momentin se kur do të shkoj në shtëpi”

(Punëtori social nga Portugalia, kodi 24.07.01)

Kur nëna ime gjeti një vend për të jetuar, babai im më tha që të shkoj në shtëpi, por unë nuk desha për arsye se më pëlqenin të dy, shkolla dhe aktivitetet(...) Unë shkova në shtëpi pas ditëlindjes time të 18(...) dhe jam i kënaqur me zgjedhjet që bëra.

(Djali nga Greqia, kodi 11.02.04)

A) Përgjegjësitë

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës

● Sigurojnë pjesëmarrjen e fëmijës/ të riut

Organizata e përkujdesjes

● Siguron që të përmbushen të gjitha kërkesat lidhur me pjesëmarrjen e fëmijës/ të riut në procesin e largimit nga përkujdesja

Kujdestari

- I jep të drejtë fëmijës/ të riut që të merr pjesë në procesin e largimit nga përkujdesja
- Përfshinë fëmijën/ të riun në planifikimin dhe zbatimin e procesit të largimit nga përkujdesja në pajtim me nivelin e tij/saj të të kuptuarit.
- Bashkëpunon me familjen biologjike

B) Udhëzuesit

1. Kërkesat në vijim merren parasysh për të siguruar pjesëmarrjen e fëmijës/ të riut

Të gjitha palët relevante të përfshira në procesin e largimit nga përkujdesja konsiderojnë dhe përmbushin së paku kërkesat në vijim për të siguruar që:



- fëmija/ i riu të ushtrojë të drejtën e tij/saj për të marrë pjesë në planifikimin dhe zbatimin e procesit e largimit të tij/saj nga përkujdesja
- fëmija/ i riu dëgjohe dhe inkurajohet që të shpreh planin e tij/saj, dyshimet dhe shpresat;
- fëmija/ i riu përkrahet në marrjen e vendimeve sipas nivelit të tij/saj të të kuptuarit
- fëmija/ i riu njihet si ekspert i jetës së tij/ saj
- familja biologjike merr pjesë në procesin e largimit nga përkujdesja
- fëmijës / të riut i jepet mundësia të përcaktoj se deri në çfarë mase mund të përfshihet familja biologjike
- fëmija/ i riu dëgjohe dhe përkrahet në procedurat juridike dhe burokratiken

2. Fëmija/ i riu merr të gjitha informatat relevante

Kujdestari siguron që fëmijës/ të riut i ofrohen të gjitha informatat relevante me qëllim që ai/ ajo të përkrahet në marrjen e vendimeve gjatë procesit të largimit nga përkujdesja.

Ai/ ajo siguron që fëmija/ i riu të kuptoj informatat e ofruara.

3. Planifikimi dhe zbatimi i procesit të largimit nga përkujdesja bazohet në planin e përkujdesjes individuale

Fëmija/ i riu merr pjesë në zhvillimin e planit të tij/saj të përkujdesjes. Plani i përkujdesjes merr parasysh pikëpamjet e tij/ saj si dhe qëllimet dhe burimet e nevojshme që të planifikoj dhe zbatoj në tërësi procesin e largimit nga përkujdesja.

C) Shenjat Paralajmëruese

- Nuk ka kërkesa minimale lidhur me pjesëmarrjen e fëmijës/ të riut në procesin e largimit nga përkujdesja.
- Nuk zbatohen kërkesat minimale.
- Fëmija/ i riu ndihet që ai/ ajo nuk po merr pjesë të mjaftueshme në procesin e largimit nga përkujdesja.
- Fëmija/ i riu nuk ndihet të jetë i informuar mirë.
- Planifikimi dhe zbatimi i procesit të përkujdesjes nuk bazohet në planin e përkujdesjes individuale.
- Fëmija/ i riu ndihet se ai/ ajo nuk po kuptohet seriozisht.
- Merren vendime relevante pa pjesëmarrjen e fëmijës/ të riut.
- Fëmijës/ të riut i jepet më shumë përgjegjësi se që ai/ ajo mund ti përballoj.
- Fëmija/ i riu nuk dëgjohe, nuk përkrahet në procedurat juridike dhe burokratike

Standardi 18 Sigurohet përcjellja, përkrahja e vazhdueshme dhe mundësia për kontaktim

Pasi që fëmija/ i riu të jetë larguar nga përkujdesja jashtë shtëpisë, ai/ ajo ka mundësi të marr ndihmë dhe përkrahje. Organizata e përkujdesjes përpiqet të siguroj që ai/ ajo të mos e ndiejnë procesin e largimit nga përkujdesja si një përçarje të re.

Kur i riu është i mitur, organizata e përkujdesjes duhet të vazhdojë të ofroj përkrahje dhe mundësi për të mbajtur kontaktin.

*“Bie zilja e derës (...) hapa derën dhe ja punëtori im social, duart plot me ushqime dhe më pyet” A dëshiron në hash me mua?” Kjo ishte pikërisht ajo që më nevojitej
(...) Ai erdhi vetëm për mua dhe qëndroj për një kohë- ishte një mbrëmje e mirë dhe unë atë natë fjeta mirë”.*

(Djali nga Norvegjia, kodi 22.01.01)

“Megjithatë, SOS Fshati i fëmijëve mundet gjithmonë të ofroj komoditet për arsye se edhe kur ata largohen, ne nuk i braktisim dhe në disa raste mundësia që të kthehen madje edhe për një kohë të shkurtër, ju jep atyre stabilitetin që ju nevojitet”

(Drejtori i Organizatës së përkujdesjes nga Portugalia, kodi 24.07.02)

A) Përgjegjësitë

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës

- Sigurojnë përcjelljen dhe përkrahjen e vazhdueshme edhe pasi që fëmija arrin moshën madhore.
- Ndihmojnë kontaktin ndërmjet fëmijës dhe të riut dhe rrjetin e saj/ tij emocional relevant gjatë kohës së përkujdesjes

Organizata e përkujdesjes

- Siguron zhvillimin dhe zbatimin e planit të pas-përkujdesjes .
- Siguron burime të nevojshme për përcjelljen dhe përkrahjen e vazhdueshme dhe garanton që fëmija ka mundësi të mbaj kontakte me kujdestarin e tij/saj të mëparshëm dhe rrjetin emocional relevant gjatë kohës së përkujdesjes.

Kujdestari

- Së bashku me fëmijën/ të riun zhvillon dhe zbaton planin e pas-përkujdesjes.
- Përcjell, përkrah fëmijën/ të riun dhe ndihmon kontaktet ndërmjet fëmijës/ të riut dhe rrjetit e tij/saj emocional relevant gjatë kohës së përkujdesjes



B) Udhëzuesit

1. Përcjellja dhe përkrahja bazohen në planin e pas-përkujdesjes

Organizata e përkujdesjes dhe kujdestari së bashku me fëmijën/ të riun zhvillojnë dhe zbatojnë planin e pas-përkujdesjes. Ky plan ngritet mbi planin e përkujdesjes individuale që tashmë ekziston. Metodrat që përdoren në krijimin e planit të pas-përkujdesjes janë të përshkruara në deklaratën e shkruar të organizatës së përkujdesjes.

Është me rëndësi që plani i pas-përkujdesjes ka një fokusim individual dhe integron prapavijën e fëmijës/ të riut. Në përgjithësi, plani i pas-përkujdesjes përcakton statusin zhvillimor të fëmijës të riut, cakton qëllime dhe masa dhe sqaron burimet e nevojshme për të përkrahur fëmijën/ të riun pas që të largohet nga përkujdesja.

2. Sigurohet përcjellje dhe përkrahje fëmijës/ të riut

Kujdestari përcjell dhe nëse kërkohet përkrah fëmijën/ të riun në pajtim me planin e pas-përkujdesjes. Për këtë, ai/ ajo i ka burimet e nevojshme. Kujdestari përpiqet të mbaj kontaktin me fëmijën/ të riun.

3. Fëmija/ i riu ka mundësi të mbajtjes së kontaktit të rrjetit të tij/saj emocional

Organizata e mëparshme e përkujdesjes ofron burime për të mbajtur kontaktin ndërmjet fëmijës/ të riut dhe rrjetit të saj/ tij emocional relevant gjatë kohës së përkujdesjes. Ish kujdestari e ndihmon këtë kontakt.

C) Shenjat Paralajmëruese

- Nuk ka plan të pas-përkujdesjes.
- Nuk ka përcjellje dhe/ as përkrahje.
- Fëmija/ i riu nuk është mjaft i përfshirë në zhvillimin e planit të pas-përkujdesjes.
- Fëmija/ i riu refuzon përcjelljen dhe/ ose përkrahjen.
- I riu nuk përkrahet më, pas moshës 18 vjeçare.
- Fëmija/ i riu nuk ka mundësi të mbaj kontakt me rrjetin e saj/ tij emocional relevant gjatë kohës së përkujdesjes





Fjalori i terminologjisë së shfrytëzuar

Familja biologjike

Anëtarët e familjes me të cilët fëmija ka lidhje biologjike, siç janë prindërit, vëllezërit/ motrat dhe të afërmit e tjerë.

Kujdestari

Anëtari i familjes ose profesionisti që ofron kujdes për fëmijën/ të riun. Këta mund të jenë kujdestarët që kujdesen në familje ose në procesin e përkujdesjes.

Organizata e përkujdesjes

Organizata përgjegjëse për përkujdesjen e përditshëm jashtë shtëpisë të fëmijës. Kjo mund të ofrohet përmes familjeve strehuese ose llojeve tjera (siç është SOS Fshati i fëmijëve) ose objektet e banimit.

Plani i përkujdesjes individuale

Plani që ka për qëllim që të udhëheq zhvillimin fizik, njohës, emocional dhe shoqëror të fëmijës. Krijohet gjatë procesit të vendimmarrjes dhe më tutje zhvillohet dhe zbatohet gjatë tërë procesit të përkujdesjes jashtë shtëpisë. Në përgjithësi, plani i përkujdesjes përcakton statusin zhvillimor të fëmijës, vendos qëllimet dhe masat dhe sqaron burimet e nevojshme për të përkrahur tërë zhvillimin e fëmijës. Çdo vendim relevant gjatë procesit të përkujdesjes jashtë -shtëpisë udhëhiqet me këtë plan.

Fëmija

Çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeçare.

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës

Organizatrat, institucionet, shërbimet dhe/ ose institucionet për ofrimin e përkujdesjes, përkrahin dhe / ose mbrojnë fëmijët dhe të rinjtë, të cilëve familjet biologjike ose kujdestarët nuk ua plotësojnë nevojat e tyre. Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës ofrojnë informata dhe rregullojnë përkujdesjen shoqëror, mjekësor, ligjor dhe/ ose kujdestarinë. Shërbimet për mbrojtjen e fëmijës mund të jenë publike ose private (shërbimet për mirëqenien e të rinjve, organizatat joqeveritare e tij).

Fëmijët me nevoja të veçanta

Fëmijët me çrregullime psikologjike, dëme fizike ose paaftësi intelektuale ose rrethanave kulturore, historisë së abuzimit, neglizhencës ose faktorëve të tjerë, kërkojnë kujdes të veçantë dhe masa mbrojtje që ofrojnë kujdestarët specialist ose terapistët gjatë vendosjes në përkujdesjen jashtë-shtëpisë.

Ekipi shumë-profesional

Ekipi i ngarkuar që të përkrah zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës gjatë vendosjes së tij/ saj në përkujdesjen për fëmijë jashtë-shtëpisë. Ky ekip përbëhet nga kujdestarët, edukatorët dhe bashkëpunëtorët përkrahës të organizatës së përkujdesjes (psikologët, punëtorët social etj.)

I riu

Një i ri/e re që është 18 vjeç ose më i vjetër por që për shkak të situatës së tij/ saj të veçantë ka ende të drejtë të jetojë në përkujdesjen jashtë-shtëpisë.



Shtojcë

Korniza e referencës në Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF e KB)¹

Në vitin 1989, Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoj dhe e hapi për ratifikim Konventën për të drejtat e fëmijës; të gjitha shtetet e Evropës e ratifikuan atë. Me ratifikim, shteti konfirmon që do të bëjë gjithçka që është e mundur për të zbatuar dispozitat dhe për të mbrojtur të gjithë fëmijët që janë nën juridiksionin e vet nga shkeljet e të drejtave të tyre. Ka disa mënyra për të shfrytëzuar KDF të KB-së, tri nga ato janë:

- Si mjet ligjor: KDF e KB-së mund të bëhet pjesë e jurisprudencës ose të drejtës precedente
- Si një porosi edukative
- Si një instrument politiko-shoqëror

Të drejtat e fëmijës janë më tepër se sa pozita ligjore e fëmijës. Nuk është fjala vetëm për ligjet, vendimet dhe rregullat. Por, po ashtu për obligimet e qeverive për të realizuar të drejtat e fëmijës dhe ti zbatojnë ato në çdo aspekt të shoqërisë. KDF e KB-së mund të shfrytëzohet për tu treguar qeverive kur ato dështojnë të përmbushin përgjegjësitë e tyre.

KDF përmban porosi edukative. Kjo, po ashtu është e rëndësishme për përkujdesjen e fëmijëve jashtë-shtëpisë. Porosia edukative në konventë mund të gjendet në konceptet që vijnë nga edukatorët ose teoritë psikologjike të fëmijës. Shembujt e këtyre koncepteve në KDF janë:

- interesi më i mirë për fëmijën (paragrafi 1 i nenit 3)
- evoluimi i kapacitete (neni 5);
- pjekuria (neni 12)
- dinjiteti (në 7 pjesë të ndryshme në tërë konventën).

Është detyrë e edukatorit, psikologut por edhe e prindërve dhe kujdestarit që këto koncepti ti vejnë në praktikë. Në disa pika, konventa drejtpërdrejtë i adresohet edukatorëve, përfshirë prindërit (neni 3,5 18) punëtorëve të edukimit/shkollave (neni 28,29) dhe Shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës/ institucionet për mirëqenie (paragrafi 1 dhe 3 të nenit 3).

Struktura e referencës jep një këndvështrim të neneve të Konventës për të drejtat e fëmijës e Kombeve të Bashkuara, që përmban dispozita lidhur me përmbajtjen e standardeve të cilësisë për fëmijët . Një këndvështrim mbi këto dispozita mund të gjendet në CD të CPF-së.



Nenet në Konventën mbi Të Drejtat e Fëmijës të cilat përmbajnë provizionet të lidhura me Standardet e cilësisë së fëmijëve

Standardi 1: Fëmija dhe familja e tij/saj biologjike përkrahen gjatë procesit të vendimmarrjes

Për fëmijën: Nenet:3 (paragrafi 1), 6 (paragrafi 2), 9 (paragrafi 2), 12, 23 dhe 39

Për prindërit: Nenet:3 (paragrafi 1), 5,6 (paragrafi 2),9 (paragrafi 2),12,13 dhe 18 (paragrafi 2)

Për shërbimet e mbrojtjes së fëmijës ose organizatat e përkujdesjes: Nenet:2,3 (paragrafi 1,2 dhe 3),5,6 (paragrafi 2), 9 (paragrafi 2), 12, 13, 18 (paragrafi 2), 19,20 (paragrafi 1),39

Për personin përgjegjës ose kujdestarin: Nenet: 2,3 (paragrafet 1 dhe 2) 5,6 (paragrafi 2), 9 (paragrafi 2), 12,13,19,29 (paragrafi 1), 39

Standardi 2: Fëmija nxitet të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes

Për fëmijën: Nenet: 9 (paragrafi 2), 12, 13,17

Për prindërit: Nenet:3 (paragrafi 1), 5,6 (paragrafi 2),9 (paragrafi 2),12,13,17, 18 (paragrafi 1)

Për shërbimet e mbrojtjes së fëmijës ose organizatat e përkujdesjes: Nenet:2,3 (paragrafet 1 dhe 3),6 (paragrafi 2), 9 (paragrafi 2), 5, 12, 13,17,39

Për personin përgjegjës ose kujdestarin: Nenet: 2 (paragrafi 1), 3 (paragrafi 1), 5,6 (paragrafi 2), 9 (paragrafi 2), 12,13, 17

Standardi 3: Një proces profesional i vendimmarrjes siguron përkujdesjen më të mirë të mundshme për fëmijën

Për fëmijën: Nenet: 3 (paragrafet 1 dhe 2), 6 (paragrafi 2),19,20 (paragrafi 1), 23 (paragrafet 1,2 dhe 3), 23 (paragrafi 1), 39

Për prindërit: Nenet:3 (paragrafi 1), 5,6 (paragrafi 2),18 (paragrafi 1), 20 (paragrafi 3), 23 (paragrafet 1,2 dhe 3),39

Për shërbimet e mbrojtjes së fëmijës ose organizatat e përkujdesjes: Nenet: 2,3 (paragrafet 1 dhe 3),6 (paragrafi 2), 23 (paragrafet 1, 2 dhe 3), 39

Për personin përgjegjës ose kujdestarin: Nenet: 2,3 (paragrafi 1), 5,6 (paragrafi 2), 20 (paragrafi 3),23 (paragrafet 1,2 dhe 3), 39

Standardi 4: Vëllëzërit/motrat kanë të njëjtën përkujdesje

Neni 16

Standardi i 5: Kalimi në shtëpinë e re përgatitet mirë dhe zbatohet me ndjeshmëri

Për fëmijën: Nenet: 3 (paragrafet 1 dhe 2), 19,20 (paragrafet 1 dhe 3), 39

Për prindërit: Nenet:3 (paragrafi 1), 5,6 (paragrafi 2), 18 (paragrafi 1),20 (paragrafi 3), 23 (paragrafi 1), 39



Për shërbimet e mbrojtjes së fëmijës ose organizatat e përkujdesjes: Nenet:2,3 (paragrafi 1 dhe 3),5,6 (paragrafi 2), 20 (paragrafi 3), 23 (paragrafi 1), 39

Për personin përgjegjës ose kujdestarin: Nenet: 2,3 (paragrafi 1), 5,6(paragrafi 2), 20 (paragrafi 3),23 (paragrafi 1), 39

Standardi 6: Procesi i përkujdesjes jashtë-shtëpisë udhëhiqet nga një plan i përkujdesjes individuale

Për fëmijën: Nenet: 3 (paragrafet 1 dhe 2), 6 (paragrafi 2), 9 (paragrafi 2), 12,13,17,19,20 (paragrafet 1 dhe 3), 23 (paragrafi 1), 25,39

Për shërbimet e mbrojtjes së fëmijës ose organizatat e përkujdesjes: Nenet: 2,3 (paragrafet 1 dhe 3),6 (paragrafi 2), 9 (paragrafi 2), 12,13,17,20 (paragrafi 3), 23 (paragrafi 1), 25,39

Për personin përgjegjës ose kujdestarin: Nenet: 2,3 (paragrafet 1 dhe 3), 6 (paragrafi 2), 9 (paragrafi 2), 12 dhe 13,17,20 (paragrafi 3), 23 (paragrafi 1), 25,39

Standardi 7: Vendosja e fëmijës duhet të përshtatet me nevojat e tij/saj, situatën jetësore dhe ambientin shoqëror

Për fëmijën: Nenet: 3 (paragrafet 1 dhe 2), 6 (paragrafi 2),8,19,20 (paragrafet 1 dhe 3), 23 (paragrafi 1), 39

Për shërbimet e mbrojtjes së fëmijës ose organizatat e përkujdesjes: Nenet: 3 (paragrafi 1), 8,20 (paragrafi 3), 6 (paragrafi 2), 20 (paragrafi 3), 23 (paragrafi 1), 39

Për personin përgjegjës ose kujdestarin: 3 (paragrafi 1), 6(paragrafi 2), 8,20 (paragrafi 3), 23 (paragrafi 1),39

Standardi 8: Fëmija mban kontakte me familjen e tij /saj biologjike

Për fëmijën: Nenet: 9 (paragrafi 3), 20 (paragrafi 3),

Për prindërit: Nenet: 3 (paragrafi 1), 5,6 (paragrafi 2), 9 (paragrafi 3) ,18 (paragrafi 1) dhe 2

Për shërbimet e mbrojtjes së fëmijës ose organizatat e përkujdesjes: Nenet: 3 (paragrafi 1),5,6 (paragrafi 2), 9 (paragrafi 3), 18 (paragrafi 2), 20 (paragrafi 3),

Për personin përgjegjës ose kujdestarin: 3 (paragrafi 1),5, 6 (paragrafi 2), 9 (paragrafi 3), 18 (paragrafi 2), 20 (paragrafi 3)

Standardi 9: Kujdestarët janë të kualifikuar dhe kanë kushte adekuate për punë

Për fëmijën: Nenet: 3 (paragrafi 1), 2,3,6 (paragrafi 2),19,20 (paragrafi 1), 23 (paragrafi 1), 39

Për shërbimet e mbrojtjes së fëmijës ose organizatat e përkujdesjes: Nenet:3 (paragrafet 1 dhe 3), 6 (paragrafi 2), 3 (paragrafi 3), 23 (paragrafi 1),39

Për personin përgjegjës ose kujdestarin:Nenet 3 (paragrafi 3), 39,23 (paragrafi 1)

**Standardi 10: Marrëdhënia e kujdestarit me fëmijën bazohet në mirëkuptim dhe respekt**

Për fëmijën: Nenet: 23 (paragrafi 1), 39

Për shërbimet e mbrojtjes së fëmijës ose organizatat e përkujdesjes: Nenet:2,3 (paragrafi 1 dhe 3), 6 (paragrafi 2), 23 (paragrafi 1),39

Për personin përgjegjës ose kujdestarin:Nenet: 2, 3 (paragrafi 1), 6 (paragrafi 2), 23 (paragrafi 1), 39

Standardi 11: Fëmija nxitet të marr pjesë aktive në marrjen e vendimeve që ndikojnë drejtpërsëdrejti në jetën e tij/saj

Për fëmijën: Nenet: 9 (paragrafi 2), 12,13,17

Për shërbimet e mbrojtjes së fëmijës ose organizatat e përkujdesjes: Nenet:2,3 (paragrafi 1 dhe 3), 6 (paragrafi 2), 9 (paragrafi 2), 12,13,17

Për personin përgjegjës ose kujdestarin: 2, 3 (paragrafi 1), 6 (paragrafi 2), 9 (paragrafi 2), 12,13,17

Standardi 12: Përkujdesja për fëmijën ofrohet në kushte të duhura jetësore

Për fëmijën: Nenet: 3 (paragrafet 1 dhe 2), 6 (paragrafi 2) , 15,20 (paragrafi 1),26,27,28,31

Për shërbimet e mbrojtjes së fëmijës ose organizatat e përkujdesjes: Nenet:3 (paragrafi 1 dhe 3),6 (paragrafi 2), 15,23 (paragrafi 1), 25,26,27,28,31,39

Për personin përgjegjës ose kujdestarin:Nenet: 6 (paragrafi 2), 3 (paragrafi 1), 11 (paragrafi 1), 15,23 (paragrafi 1), 25,26,27,28,31,39

Standardi 13: Fëmijët me nevoja të veçanta marrin përkujdesje të duhur

Për fëmijën: Nenet: 3 (paragrafet 1, 2 dhe 3), 6 (paragrafi 2) ,19,20 (paragrafi 1) ,23 (paragrafet 1,2 dhe 3),39

Për shërbimet e mbrojtjes së fëmijës ose organizatat e përkujdesjes: Nenet:2,3 (paragrafet 1 dhe 3), 6 (paragrafi 2), 23 (paragrafet 1, 2 dhe 3), 39

Për personin përgjegjës ose kujdestarin:Nenet: 2,3 (paragrafet 1 dhe 3), 6 (paragrafi 2), 23 (paragrafet 1, 2 dhe 3), 39

Standardi 14: Fëmija/ i riu vazhdimisht përgatitet për të jetuar i pavarur

Për fëmijën: Nenet: 3 (paragrafet 1 dhe 2), 6 (paragrafi 2) ,9 (paragrafi 2) ,12,13,17, 19,20 (paragrafi 1),26,28,39

Për shërbimet e mbrojtjes së fëmijës ose organizatat e përkujdesjes: Nenet:3 (paragrafet 1 dhe 3),6 (paragrafi 2), 9 (paragrafi 2), 12, 13,17,26,28,39

Për personin përgjegjës ose kujdestarin:Nenet:3 (paragrafet 1 dhe 3), 6 (paragrafi 2), 9 (paragrafi 2),12,13,17,26,28,39

Standardi 15: Procesi i largimit nga përkujdesja planifikohet dhe zbatohet me kujdes të veçantë

Për fëmijën: Nenet: 3 (paragrafi 1), 3 (paragrafet 2 dhe 3), 6 (paragrafi 2), 9 (paragrafi 2), 12,13,17,19,20 (paragrafi 1),25,39

Për shërbimet e mbrojtjes së fëmijës ose organizatat e përkujdesjes: Nenet:3 (paragrafet 1 dhe 3),6 (paragrafi 2), 9 (paragrafi 2), 12, 13,17,26,39

Për personin përgjegjës ose kujdestarin:Nenet:3 (paragrafet 1 dhe 3), 6 (paragrafi 2), 9 (paragrafi 2),12,13,17,26,39

Standardi 16: Komunikimi në procesin e largimit nga përkujdesja bëhet në mënyrë të duhur dhe të dobishme

Për fëmijën: Nenet: 3 (paragrafet 1 dhe 2), 9 (paragrafi 2),12,13,16,17,19,20 (paragrafi 1), 23 (paragrafi 1), 39

Për prindërit: Nenet: 5,17,3 (paragrafi 1), 6 (paragrafi 2), 9 (paragrafi 2),12,13,16,18 (paragrafet 1 dhe 2)

Për shërbimet e mbrojtjes së fëmijës ose organizatat e përkujdesjes: Nenet: 3 (paragrafet 1 dhe 3),5,6 (paragrafi 2), 9 (paragrafi 2), 12,13,16,17,39

Për personin përgjegjës ose kujdestarin: Nenet:3 (paragrafet 1 dhe 3), 5,6 (paragrafi 2), 9 (paragrafi 2),12,13,16,17,39

Standardi 17: Fëmija/ i riu nxitet të marr pjesë në procesin largimit nga përkujdesja

Për fëmijën: Nenet: 3 (paragrafet 1 dhe 2), 5,6 (paragrafi 2), 18 (paragrafi 2), 19,20 (paragrafi 1), 26,39

Për shërbimet e mbrojtjes së fëmijës ose organizatat e përkujdesjes: 3 (paragrafi 1), 5,6 (paragrafi 2), 18 (paragrafi 2), 39,23 (paragrafi 1),26

Për personin përgjegjës ose kujdestarin:Nenet:3 (paragrafi 1), 5,6 (paragrafi 2), 3 (paragrafi 1),39,23 (paragrafi 1),26

Standardi 18:Sigurohet përcjellja, përkrahja e vazhdueshme dhe mundësitë për kontaktim

Për fëmijën: Nenet: 3 (paragrafet 1 dhe 2), 6 (paragrafi 2),19,20 (paragrafi 1), 26,39

Për prindërit: Nenet:3 (paragrafi 1), 5,6,18 (paragrafet 1 dhe 2), 26

Për shërbimet e mbrojtjes së fëmijës ose organizatat e përkujdesjes: Nenet: 3 (paragrafi 1), 5,6 (paragrafi 2), 18 (paragrafi 2), 23 (paragrafi 1),26,39

Për personin përgjegjës ose kujdestarin: 3 (paragrafi 1), 5,6 paragraf,23 (paragrafi 1),26,39



Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës

Miraturuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989

Preambula

Shtetet Palë në këtë Konventë,

Duke pasur parasysh se, në përputhje me parimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara, njohja e dinjitetit të lindur dhe e të drejtave të barabarta e të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është baza e lirisë, drejtësisë dhe e paqes në botë,

Duke mbajtur parasysh faktin se popujt e Kombeve të Bashkuara kanë ripohuar në Kartë besimin e tyre në të drejtat themelore të njeriut dhe në dinjitetin dhe vlerën e njeriut dhe kanë vendosur të nxisin përparimin shoqëror e të krijojnë kushte më të mira jetese, në një liri më të madhe,

Duke pranuar se Kombet e Bashkuara, në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe në Paktet ndërkombëtare mbi të Drejtat e Njeriut, kanë shpallur dhe kanë pranuar që çdonjëri mund të përfitojë nga të gjitha të drejtat dhe të gjitha liritë e parashtruara në to, pa asnjë dallim race, ngjyre, gjinie, gjuhe, feje, opinioni politik ose çdo lloj opinioni tjetër, origjine kombëtare ose shoqërore, pasurie, prejardhjeje ose çdo lloj gjendjeje tjetër,

Duke kujtuar se në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Kombet e Bashkuara kanë shpallur që mosha e fëmijërisë ka të drejtë për një përkujdesje dhe përkrahje të veçantë,

Të bindur se familja, si njësi bazë e shoqërisë dhe mjedis natyror për rritjen dhe mirëqenien e të gjithë anëtarëve të saj dhe veçanërisht të fëmijëve, duhet të ketë mbrojtjen dhe përkrahjen e nevojshme që të mund të marrë përsipër plotësisht rolin e saj në bashkësi,

Duke pranuar se fëmija, për zhvillimin e plotë dhe të harmonishëm të personalitetit të tij, duhet të rritet në mjedis familjar, në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi

Duke pasur parasysh se fëmija duhet të përgatitet plotësisht për të bërë një jetë individuale në shoqëri dhe të edukohet në frymën e idealeve të shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe sidomos në frymën e paqes, të dinjitetit, tolerancës, lirisë, barazisë dhe solidaritetit, Duke mbajtur parasysh se domosdoshmëria për t'i dhënë një mbrojtje të posaçme fëmijës është pohuar në Deklaratën e Gjenevës mbi të Drejtat e Fëmijës të vitit 1924 dhe në Deklaratën mbi të Drejtat e Fëmijës të miraturuar nga Kombet e Bashkuara më 20 nëntor 1959 dhe që është njohur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (në veçanti në nenet 23 dhe 24), në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (në veçanti në nenin 10) dhe në statutet e instrumentet përkatëse të agjencive të specializuara dhe të organizatave ndërkombëtare, që merren me mirëqenien e fëmijës,

Duke mbajtur parasysh se, ashtu siç është thënë në Deklaratën e të Drejtave të Fëmijës “fëmija, për shkak të papjekurisë së tij fizike dhe intelektuale ka nevojë për një mbrojtje dhe kujdes të posaçëm, përfshirë mbrojtjen juridike të përshtatshme, si para ashtu dhe pas lindjes”,

Duke kujtuar dispozitat e Deklaratës mbi Parimet Shoqërore dhe Juridike lidhur me Mbrojtjen dhe Mirëqenien e Fëmijëve, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me vendosjen e fëmijës në një familje ushqyese dhe strehimin e fëmijës brenda dhe jashtë vendit; me rregullat minimale standard të Kombeve të Bashkuara mbi administrimin e drejtësisë për të miturit (Rregullat e Pekinit) dhe të Deklaratës mbi Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve në Periudha të Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe Konflikti të Armatosur, Duke pranuar se në të gjitha vendet e botës ka fëmijë që jetojnë në kushte jashtëzakonisht të vështira dhe se është e nevojshme që këtyre fëmijëve t’u kushtohet një vëmendje e veçantë,

Duke mbajtur parasysh si duhet rëndësinë e traditave dhe të vlerave kulturore të çdo populli në mbrojtjen dhe zhvillimin e harmonishëm të fëmijës,

Duke pranuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për përmirësimin e kushteve të jetesës së fëmijëve në të gjitha vendet, dhe veçanërisht në vendet në zhvillim,

U morën vesh për sa vijon,

Pjesa I

Neni 1

Në këtë Konventë, me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet.

Neni 2

1. Shtetet Palë angazhohen të respektojnë të drejtat e përmedura në këtë Konventë dhe t’ia garantojnë ato çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinionin politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë.

2. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë efektivisht i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinionëve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij.

Neni 3

1. Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.

2. Shtetet Palë angazhohen që t’i sigurojnë fëmijës mbrojtjen dhe përkujdesjen e nevojshëm për mirëqenien e tij, duke pasur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tij, të kujdestarëve të tij ligjorë ose të personave të tjerë ligjorisht përgjegjës për të dhe, për këtë qëllim, ata marrin të gjitha masat legjislative dhe administrative përkatëse.



3. Shtetet Palë marrin masa që institucionet, shërbimet dhe qendrat që përgjigjen për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e sigurisë, të shëndetit, të numrit dhe aftësive të personelit të tyre si dhe të kontrollit të duhur.

Neni 4

Shtetet Palë angazhohen të marrin të gjitha masat legislative, administrative e të tjera të nevojshme, për të vënë në jetë të drejtat e njohura në këtë Konventë. Lidhur me të drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore, Shtetet Palë marrin të gjitha masat e mundshme, në bazë të burimeve që disponojnë dhe, kur është nevoja, në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Neni 5

Shtetet Palë respektojnë përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat që kanë prindërit ose, sipas rastit, anëtarët e familjes së zgjeruar ose të bashkësisë, siç parashikohet nga zakoni i vendit, kujdestarët ose persona të tjerë ligjërisht përgjegjës për fëmijën, për t'i dhënë këtij, në përputhje me zhvillimin e aftësive të tij, drejtimin dhe udhëheqjen e duhur për ushtrimin e të drejtave që i njeh atij kjo Konventë.

Neni 6

1. Shtetet Palë njohin se çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar.
2. Shtete Palë, marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës.

Neni 7

1. Fëmija regjistrohet menjëherë sapo lind dhe qysh atëherë ka të drejtën të ketë një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi dhe, brenda mundësive, të drejtën për të njohur prindërit e tij dhe për të pasur përkujdesjen e tyre.
2. Shtetet Palë sigurojnë zbatimin e këtyre të drejtave, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar dhe me detyrimet që rrjedhin nga instrumentet përkatëse ndërkombëtare në këtë fushë, sidomos në rastet kur, në mungesë të tyre, fëmija do të mbetet pa shtetësi.

Neni 8

1. Shtetet Palë marrin përsipër të respektojnë të drejtën e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij, përfshirë këtu shtetësinë, mbiemrin dhe lidhjet familjare, sipas ligjit, pa ndërhyrje të paligjshme.
2. Në qoftë se një fëmijë i mohohen në mënyrë të paligjshme disa ose të gjithë elementet e identitetit të tij, Shtetet Palë i japin atij ndihmën dhe mbrojtjen e duhur, me qëllim që identiteti i tij të rivendoset shpejt.

Neni 9

1. Shtetet Palë garantojnë që fëmija të mos ndahet nga prindërit kundër dëshirës së tyre, përveç rastit kur autoritetet kompetente, në bazë të rishikimit gjyqësor, vendosin që, në përputhje me ligjin dhe procedurat përkatëse kjo ndarje është e domosdoshme, në interesin më të lartë të fëmijës. Ky vendim mund të jetë i nevojshëm në raste të veçanta, si ai kur prindërit keqtrajtojnë ose nuk kujdesen për fëmijën, ose kur ata jetojnë të ndarë dhe kur duhet vendosur se ku duhet të banojë fëmija.

2. Në të gjitha rastet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, të gjitha palët e interesuara duhet të kenë mundësinë të marrin pjesë në diskutim dhe të bëjnë të njohura mendimet e tyre.

3. Shtetet Palë respektojnë të drejtën e fëmijës së ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit, që të mbajë rregullisht marrëdhënie vetjake dhe takime të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.

4. Kur ndarja është rrjedhojë e çdo mase të marrë nga një Shtet Palë, si ndalimi, burgimi, internimi, dëbimi ose vdekja, (përfshirë këtu vdekjen për çfarëdo shkak, kur personi është i ndaluar nga shteti) e njërit ose të dy prindërve, ose të fëmijës, ky Shtet Palë, sipas kërkesës, u jep prindërve, fëmijës ose, kur është rasti, një anëtar tjetër të familjes, të dhëna të hollësishme mbi vendin ku ndodhen anëtarët ose anëtarët e familjes, me përjashtim të rasteve kur dhënia e këtyre të dhënave dëmton mirëqenien e fëmijës. Shtetet Palë sigurojnë gjithashtu, që paraqitja e një kërkesë të tillë të mos sjellë në vetvete pasoja të dëmshme për personin ose personat e interesuar.

Neni 10

1. Në përputhje me detyrimin e Shteteve Palë sipas paragrafit 1 të nenit 9, kërkesat e bëra nga një fëmijë ose nga prindërit e tij, me qëllim që të hyjnë në një Shtet Palë ose të largohen prej tij, për arsye ribashkimi të familjes, trajtohen nga Shtetet Palë në një frymë pozitive, me humanizëm dhe me shpejtësi. Shtetet Palë sigurojnë gjithashtu që paraqitja e një kërkesë të tillë të mos sjellë pasoja të dëmshme për autorët e kërkesës dhe anëtarët e familjes së tyre.

2. Një fëmijë, prindërit e të cilit banojnë në shtete të ndryshme, ka të drejtë të mbajë marrëdhënie personale dhe takime të rregullta të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme. Për këtë qëllim dhe në përputhje me detyrimin e Shteteve Palë, sipas paragrafit 1 të nenit 9, Shtetet Palë respektojnë të drejtën e fëmijës dhe të prindërve të tij për t'u larguar nga çdo vend, përfshirë këtu edhe të vetin, si dhe të kthehen në vendin e tyre. E drejta për t'u larguar nga çdo vend bëhet objekt kufizimesh vetëm në rastet e përcaktuara me ligj, të cilat janë të nevojshme për të mbrojtur sigurimin kombëtar, rendin publik, shëndetin dhe moralin publik ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve dhe që janë në pajtim me të drejtat e njohura në këtë Konventë.

Neni 11

1. Shtetet Palë marrin masa për të luftuar zhvendosjet dhe mosrikthimet e paligjshme të fëmijëve në vend të huaj.

2. Për këtë qëllim, Shtetet Palë nxisin përfundimin e marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe ose aderimin në marrëveshjet ekzistuese.

Neni 12

1. Shtetet Palë i garantojnë fëmijës, i cili është i aftë të ketë pikëpamjet e tij, të drejtën për t'i shprehur lirisht këto pikëpamje, për çdo çështje që ka të bëjë me të, duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij.



2. 2. Për këtë qëllim, fëmijës i jepet mundësia që të dëgjohet në çdo procedurë gjyqësore ose administrative, që ka të bëjë me të, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi ose të një organi të përshtatshëm, në përputhje me rregullat e procedurës së legjislacionit kombëtar

Neni 13

1. Fëmija ka të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë për të kërkuar, për të marrë dhe për të përcjellë informacione dhe ide të çdo lloji, pa marrë parasysh kujfijtë, në formë gojore, të shkruar, të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur nga fëmija.

2. Ushtrimi i kësaj të drejte mund t'i nënshtrohet disa kufizimeve, por vetëm kur përcaktohen me ligj dhe janë të domosdoshme për:

(a) Respektimin e të drejtave ose reputacionit të tjerëve; ose

(b) Mbrojtjen e sigurimit kombëtar, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik.

Neni 14

1. Shtetet Palë respektojnë të drejtën e fëmijës për lirinë e mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë.

2. Shtetet Palë respektojnë të drejtat dhe detyrimet e prindërve dhe, sipas rastit, të përfaqësuesve ligjorë të fëmijës, për ta drejtuar atë në ushtrimin e të drejtës së tij, në përputhje me zhvillimin e aftësive të tij.

3. Liria për të manifestuar fenë ose bindjet e tij mund t'u nënshtrohet vetëm kufizimeve të përcaktuara me ligj dhe që janë të domosdoshme për të mbrojtur sigurinë publike, rendin publik, shëndetin dhe moralin publik, ose liritë dhe të drejtat themelore të tjerëve.

Neni 15

1. Shtetet Palë njohin të drejtat e fëmijës për lirinë e organizimit dhe lirinë e grumbullimit paqësor.

2. Asnjë kufizim nuk mund të ketë në ushtrimin e këtyre të drejtave, përveç atyre të përcaktuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurimit kombëtar, të sigurisë publike ose të rendit publik, ose për të mbrojtur shëndetin ose moralin publik, ose të drejtat dhe liritë e tjerëve.

Neni 16

1. Asnjë fëmijë nuk u nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare ose të paligjshme në jetën e tij private, në familje, në shtëpi ose në korrespondencën e tij, as cënimeve të kundërligjshme të nderit dhe reputacionit të tij.

2. Fëmija ka të drejtën e mbrojtjes me ligj kundër ndërhyrjeve ose cënimeve të tilla..

Neni 17

Shtetet Palë njohin funksionin e rëndësishëm që përmbushin mjetet e komunikimit masiv dhe garantojnë që fëmija të marrë informacione dhe materiale që vijnë nga burime të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, sidomos ato që synojnë të rrisin mirëqenien e tij shoqërore, shpirtërore e morale, si dhe shëndetin e tij fizik dhe mendor.

- (a) Inkurajojnë mjetet e komunikimit masiv për të përhapur një informacion dhe materiale me dobi shoqërore dhe kulturore për fëmijën dhe në përputhje me frymën e nenit 29;
- (b) Inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në prodhimin, shkëmbimin dhe shpërndarjen e të tilla informacioneve dhe materialeve nga burime të ndryshme kulturore, kombëtare e ndërkombëtare;
- (c) Inkurajojnë prodhimin dhe përhapjen e librave për fëmijë;
- (d) Inkurajojnë mjetet e komunikimit masiv, mbajnë parasysht, në mënyrë të veçantë nevojat gjuhësore, të fëmijës që i përket një grupi etnik ose është autokton;
- (e) Nxisin përpunimin e orientimeve të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës nga informacioni dhe materialet që dëmtojnë mirëqenien e tij, duke pasur parasysht dispozitat e neneve 13 dhe 18.

Neni 18

1. Shtetet Palë përpiqen me të gjitha mundësitë, për të siguruar njohjen e parimit, sipas të cilit të dy prindërit kanë përgjegjësi të përbashkët për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës. Përgjegjësinë kryesore për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës e kanë prindërit, ose sipas rastit, përfaqësuesit e tij ligjorë. Ata duhet të udhëhiqen, në radhë të parë, nga interesi më i lartë i fëmijës.
2. Për të garantuar dhe zhvilluar të drejtat e përmendura në këtë Konventë, Shtetet Palë u japin ndihmën e duhur prindërve dhe përfaqësuesve ligjorë të fëmijës, në ushtrimin e përgjegjësisë që u bie atyre për rritjen e fëmijës dhe sigurojnë ngritjen e institucioneve, qendrave ose shërbimeve të përkujdesjes për fëmijët.
3. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme për t'u siguruar fëmijëve, prindërit e të cilëve janë në marrëdhënie pune, të drejtën të përfitojnë nga shërbimet dhe lehtësitë e përkujdesjes për fëmijët, për të cilat janë ngritur.

Neni 19

1. Shtetet Palë marrin të gjitha masat legislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar.
2. Këto masa mbrojtjeje përfshijnë, kur është e përshtatshme, procedura të efektshme për hartimin e programeve shoqërore për përkrahjen e nevojshme të fëmijës dhe atyre që kujdesen për të, si dhe për forma të tjera parandalimi dhe identifikimi, raportimi, referimi, hetimi, trajtimi dhe ndjekjeje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, të përshkruara më lart, duke përfshirë, nëse duhet, procedurat e ndërhyrjes gjyqësore.



Neni 20

1. Një fëmije, të cilit i mohohet në mënyrë të përkohshme ose të përhershme mjedisi i tij familjar, ose kur nuk është në interesin e tij më të lartë të qëndrojë në këtë mjedis, ka të drejtë për një mbrojtje dhe një ndihmë të posaçme nga shteti.

2. Shtetet Palë sigurojnë për këtë fëmijë një përkujdesje alternative, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm.

3. Kjo përkujdesje alternative mund të ketë, *inter alia*, formën e vendosjes në një familje, të “Kafalasë” sipas të drejtës islamike, të strehimit ose, në rast nevoje, të vendosjes në një qendër të përshtatshme të përkujdesjes për fëmijët. Në gjetjen e këtyre zgjidhjeve, duhet të mbahen mirë parasysh dëshira për vazhdimësinë në edukimin e fëmijës, si dhe origjina e tij etnike, fetare, kulturore dhe gjuhësore.

Neni 21

Shtetet Palë, të cilët pranojnë dhe/ose lejojnë sistemin e strehimit, garantojnë që konsiderata mbizotëruese të jetë interesi më i lartë i fëmijës dhe:

(a) Sigurojnë që strehimi i fëmijës të autorizohet vetëm nga autoritetet kompetente, të cilët përcaktojnë, në përputhje me ligjin dhe procedurat e zbatueshme dhe mbi bazën e të gjitha të dhënave përkatëse dhe të besueshme, që strehimi të lejohet duke mbajtur parasysh gjendjen e fëmijës në raport me prindërit, të afërmit dhe përfaqësuesit e tij ligjorë dhe, kur është e nevojshme, personat e interesuar të kenë dhënë pëlqimin e tyre të ndërgjegjshëm për strehimin, mbi bazën e këshillimit të nevojshëm;

(b) Pranojnë se strehimi në një vend tjetër mund të shihet si një alternativë për të siguruar përkujdesjen për fëmijën, në qoftë se fëmija nuk mund të vendoset në një familje ushqyese ose strehuese, ose të ketë një mënyrë tjetër të përshtatshme përkujdesjeje në vendin e tij biologjike;

(c) Sigurojnë që, në rast strehimi në një vend tjetër, fëmija të gëzojë mbrojtjen dhe normat e barazvlershme me ato që ekzistojnë në rastin e strehimit në vendin e tij;

(d) Marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar që, në rast strehimi në një vend tjetër, vendosja e fëmijës të mos kthehet në një përfitim material të pavend për personat e implikuar në të;

(e) Mbështesin, sipas rastit, objektivat e këtij neni, duke përfunduar rregullime ose marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe dhe përpiqen në këtë kuadër të sigurojnë që vendosja e fëmijës në një vend tjetër të bëhet nga autoritetet ose organet kompetente.

Neni 22

1. Shtetet Palë marrin masat e duhura për të siguruar që një fëmijë, i cili kërkon të marrë statusin e refugjatit ose që konsiderohet si i tillë sipas rregullave dhe procedurave të së drejtës ndërkombëtare ose të brendshme të zbatueshme, qoftë vetëm apo i shoqëruar nga prindërit e tij ose nga çdo person tjetër, të përfitojë nga mbrojtja dhe përkrahja humanitare e duhur, për t'i lejuar atij të gëzojë të drejtat që i njohin kjo Konventë dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut ose me karakter humanitar, në të cilat Shtetet janë Palë.



2. Për këtë qëllim, Shtetet Palë bashkëpunojnë, kur e gjykojnë të nevojshme, në çdo përpjekje të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe të organizatave të tjera ndërqeveritare ose joqeveritare kompetente, që bashkëpunojnë me Organizatën e Kombeve të Bashkuara për të mbrojtur dhe ndihmuar fëmijën dhe për të kërkuar prindërit ose anëtarët e tjerë të familjes të çdo fëmije refugjat, me qëllim që të sigurojnë informacionin e nevojshëm për bashkimin me familjen. Në rastet kur as prindërit, as anëtarët e tjerë të familjes nuk gjenden, fëmijës do t'i jepet e njëjta mbrojtje, si çdo fëmije tjetër që i mungon ngaherë ose përkohësisht mjedisi familjar, cilado qoftë arsyeja, sikundër parashikohet në këtë Konventë.

Neni 23

1. Shtetet Palë pranojnë se fëmija me paaftësi mendore ose fizike duhet të bëjë një jetë normale dhe të përshtatshme, në kushte që garantojnë dinjitetin e tij, që nxisin autonominë dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e tij aktive në jetën e bashkësisë.

2. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës me paaftësi për kujdes të posaçëm dhe nxisin e sigurojnë, brenda mundësive të ardhurave të disponueshme, dhënien e fëmijës, i cili përmbush kushtet, si dhe atyre që kujdesen për të, të ndihmës që kërkohet dhe që i përshtatet gjendjes së fëmijës dhe gjendjes financiare të prindërve të tij, ose të atyre që kujdesen për të.

3. Duke njohur nevojat e veçanta të fëmijës me paaftësi, ndihma e dhënë sipas paragrafit 2 të këtij neni jepet falas sa herë të jetë e mundur, duke pasur parasysh burimet financiare të prindërve të tij ose të atyre që kujdesen për të dhe kjo synon që fëmijët me paaftësi të kenë mundësi efektivisht të marrin arsim, kualifikim, shërbime shëndetësore, shërbime riaftësimi, përgatitje për punësim dhe veprimtari argëtuese, në mënyrë që fëmija të sigurojë një integrim shoqëror dhe zhvillim vetiak sa më të plotë, përfshirë zhvillimin e tij kulturor dhe shpirtëror.

4. Shtetet Palë, në frymën e bashkëpunimit ndërkombëtar, nxisin shkëmbimin e informacionit të përshtatshëm në fushën e përkujdesjes shëndetësore parandalues dhe të trajtimit mjekësor, psikologjik dhe funksional të fëmijëve me paaftësi, përfshirë përhapjen dhe mundësinë e marrjes së informacionit lidhur me metodat e riaftësimi, edukimit dhe shërbimeve të formimit profesional, me qëllim që Shtetet Palë të kenë mundësi të përmirësojnë cilësitë dhe aftësitë e tyre dhe të zgjerojnë përvojën e tyre në këto fusha. Në këtë drejtim, duhet të mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

Neni 24

1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për të gëzuar një gjendje shëndetësore sa më të mirë dhe për të përfituar nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes dhe riaftësimin e shëndetit. Shtetet Palë përpiqen të sigurojnë që asnjë fëmije të mos i mohohet e drejta për të pasur këto shërbime të përkujdesjes shëndetësore.

2. Shtetet Palë ndjekin zbatimin e plotë të kësaj të drejte dhe në veçanti marrin masat e duhura:

(a) Për të ulur vdekshmërinë foshnjore dhe fëmimore;

(b) Për t'u siguruar të gjithë fëmijëve ndihmën e nevojshme mjekësore dhe përkujdesjen për shëndetin, duke e vënë theksin në zhvillimin e përkujdesjes shëndetësore parësore;



- (c) Për të luftuar sëmundjen dhe kequshqyerjen, edhe në kuadrin e përkujdesjes shëndetësor parësor, me anë të përdorimit, ndër të tjera, të teknikave lehtësisht të arritshme si dhe të sigurimit të produkteve ushqimore të përshtatshme dhe ujit të pijshëm të pastër, duke pasur parasysh rreziqet e ndotjes së mjedisit natyror;
- (d) Për t'u siguruar nënave përkujdesjen e duhur shëndetësor, para dhe pas lindjes;
- (e) Për të mundësuar që gjithë grupet shoqërore dhe në veçanti prindërit dhe fëmijët të marrin informacion, të kenë mundësi edukimi dhe të përkrahen për të përdorur dijet bazë për shëndetin dhe të ushqyerit e fëmijës, përparësitë e ushqyerjes me gji, higjienën dhe shëndoshjen e mjedisit dhe parandalimin e aksidenteve;
- (f) Për të zhvilluar përkujdesjen shëndetësor parandalues, këshillimin e prindërve, edukimin dhe shërbimet në fushën e planifikimit familjar.

3. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e efektshme dhe të nevojshme për të zhdukur praktikat tradicionale të dëmshme për shëndetin e fëmijëve.
4. Shtetet Palë marrin përsipër të nxisin dhe inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar, me qëllim që të sigurojnë gradualisht realizimin e plotë të së drejtës së njohur në këtë nen. Për këtë, mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

Neni 25

Shtetet Palë i njohin fëmijës, për të cilin është vendosur nga autoritetet kompetente për të qenë nën kujdesje, mbrojtje ose trajtim fizik ose mendor, të drejtën e një ekzaminimi periodik të këtij trajtimi dhe të çdo rrethane tjetër lidhur me këtë vendosje.

Neni 26

1. Shtetet Palë i njohin çdo fëmije të drejtën për të përfituar përkrahje shoqërore, përfshirë sigurime shoqërore dhe marrin masat e nevojshme për të arritur realizimin e plotë të kësaj të drejte, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar.
2. Ndhimat, ku është e nevojshme, duhet të jepen duke pasur parasysh të ardhurat dhe kushtet e fëmijës dhe personave përgjegjës për mbajtjen e tij si dhe çdo konsideratë tjetër që lidhet me kërkesën për ndihmë të bërë nga vetë fëmija ose në emër të tij.

Neni 27

1. Shtetet Palë njohin të drejtën e çdo fëmije për një nivel jetese të mjaftueshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.
2. Përgjegjësinë për të siguruar kushtet e nevojshme të jetesës për zhvillimin e fëmijës, brenda kufijve të mundësive dhe mjeteve të tyre financiare, e kanë në radhë të parë prindi ose prindërit ose personat e tjerë përgjegjës për rritjen e fëmijës.



3. Shtetet Palë marrin masat e duhura, sipas kushteve kombëtare dhe mundësive të tyre, për të ndihmuar prindërit dhe personat e tjerë përgjegjës për fëmijën, që të vënë në jetë këtë të drejtë dhe, në rast nevojë, për të siguruar një përkrahje materiale dhe programe mbështetjeje, sidomos lidhur me ushqimin, veshmbathjen dhe banimin.

4. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar marrjen e pensionit ushqimor të fëmijës nga prindërit e tij ose nga personat e tjerë që kanë përgjegjësi financiare ndaj tij, qoftë brenda ose jashtë vendit. Në veçanti, në rastet kur personi që ka një përgjegjësi financiare ndaj fëmijës jeton në një shtet tjetër nga ai i fëmijës, Shtetet Palë favorizojnë aderimin në marrëveshjet ndërkombëtare ose përfundimin e marrëveshjeve të tilla si dhe miratimin e rregullimeve të tjera të duhura.

Neni 28

1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ata:

- (a) Bëjnë arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë;
- (b) Inkurajojnë zhvillimin e formave të ndryshme të arsimit të mesëm si të përgjithshëm, dhe profesional, i bëjnë ato të hapura e të mundshme për çdo fëmijë dhe marrin masa të përshtatshme, si vendosja e arsimit falas dhe dhënia e një ndihme financiare në rast nevojë;
- (c) U sigurojnë të gjithëve arsimin e lartë, sipas aftësive të secilit, me të gjitha mjetet e përshtatshme;
- (d) Bëjnë të mundshëm dhe të arritshëm për çdo fëmijë informacionin dhe orientimin shkollor e profesional;
- (e) Marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.

2. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që disiplina shkollore të zbatohet në mënyrë të pajtueshme me dinjitetin njerëzor të fëmijës dhe në përputhje me këtë Konventë.

3. Shtetet Palë nxisin dhe inkurajojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit, për të kontribuar, në mënyrë të veçantë, në zhdukjen e padijes dhe të analfabetizmit kudo në botë dhe për të lehtësuar përvetësimin e njohurive shkencore e teknike dhe të metodave moderne të mësimdhënies. Për këtë, mbahen parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e vendeve në zhvillim.

Neni 29

1. Shtetet Palë u morën vesh që arsimimi i fëmijës të ketë për synim:

- (a) Të zhvillojë potencialin e plotë të personalitetit, dhuntive dhe aftësive mendore e fizike të fëmijës;
- (b) Të rrisë respektin për të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe për parimet e mishëruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara;
- (c) Të rrisë respektin për prindërit e fëmijës, për identitetin e tij, gjuhën dhe vlerat kulturore, për vlerat kombëtare të vendit ku fëmija jeton, të vendit biologjike dhe të qytetërimeve të ndryshme nga i veti;



- (d) Ta përgatisë fëmijën për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë, në frymë e mirëkuptimit, paqes, tolerimit, barazisë midis sekseve dhe miqësisë midis të gjithë popujve, grupeve etnike, grupeve kombëtare e fetare dhe personave me origjinë autoktone;
- (e) T'i zhvillojë fëmijës respektin për mjedisin natyror.

2. Asnjë dispozitë e këtij neni ose e nenit 28 nuk do të interpretohet në mënyrë të atillë që të çënojë lirinë e personave fizikë ose juridikë, për të krijuar e drejtuar qendra arsimore, gjithmonë me kusht që parimet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni të respektohen dhe që arsimi që jepet në këto qendra të jetë në përputhje me normat minimale që përcaktohen nga Shteti.

Neni 30

Në Shtetet ku ekzistojnë pakica etnike, fetare apo gjuhësore, ose persona me origjinë autoktone, një fëmije që i përket një minoriteti ose është autokton, nuk mund t'i mohohet e drejta për të pasur kulturën e vet, të ushtrojë dhe praktikojë fenë e vet, ose të përdorë gjuhën e vet së bashku me anëtarët e tjerë të grupit të tij.

Neni 31

1. Shtetet Palë i njohin fëmijës të drejtën të pushojë dhe argëtohet, të praktikojë lojëra dhe veprimtari çlodhëse, në përshtatje me moshën, si dhe të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore dhe artistike.
2. Shtetet Palë respektojnë dhe nxisin të drejtën e fëmijës për pjesëmarrje të plotë në jetën kulturore dhe artistike, inkurajojnë sigurimin e mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kohën e lirë dhe për veprimtari kulturore, artistike, argëtuese dhe çlodhëse.

Neni 32

1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për t'u mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rreziqe ose që çënon edukimin e tij ose dëmton shëndetin apo zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror.
2. Shtetet Palë marrin masa legislative, administrative, shoqërore dhe edukative, për të siguruar zbatimin e këtij neni. Për këtë qëllim dhe duke pasur parasysh dispozitat përkatëse të instrumenteve të tjera ndërkombëtare, Shtetet Palë në mënyrë të veçantë:
 - (a) Përcaktojnë një moshë minimale ose moshat minimale të pranimi në punë;
 - (b) Parashikojnë një rregullim të përshtatshëm të orarit të punës dhe të kushteve të punës;
 - (c) Japin dënime ose sanksione të tjera të përshtatshme për të siguruar zbatimin efektiv të këtij neni.

Neni 33

Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura, duke përfshirë ato legislative, administrative, shoqërore dhe edukative, për të mbrojtur fëmijët nga përdorimi i paligjshëm i drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope, siç përcaktohen në konventat përkatëse ndërkombëtare dhe për të mos lejuar që fëmijët të përdoren për prodhimin dhe trafikun e paligjshëm të këtyre lëndëve.

Neni 34

Shtetet Palë marrin përsipër të mbrojnë fëmijën nga çdo lloj forme e shfrytëzimit seksual dhe keqtrajtimit seksual. Për këtë qëllim, Shtetet Palë marrin në mënyrë të veçantë të gjitha masat e duhura në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh për të mos lejuar që:

- (a) Fëmijët të nxiten ose të detyrohen për t'u përfshirë në veprimtari të paligjshme seksuale;
- (b) Fëmijët të shfrytëzohen për qëllime prostitucioni ose praktika të tjera seksuale të paligjshme;
- (c) Fëmijët të shfrytëzohen për shfaqje ose materiale pornografike.

Neni 35

Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh, për të mos lejuar rrëmbimin, shitjen, ose trafikun e fëmijëve për çdo qëllim dhe në çfarëdo forme qoftë.

Neni 36

Shtetet Palë mbrojnë fëmijën nga çdo formë tjetër shfrytëzimi, që dëmton në çfarëdo aspekti mirëqënien e tij.

Neni 37

Shtetet Palë sigurojnë që:

- (a) Asnjë fëmijë të mos i nënshtrohet torturës, as trajtimeve ose dënimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese. As dënimi me vdekje, as burgimi i përjetshëm nuk duhet të jepet për shkelje të ligjit; të kryera nga persona nën 18 vjeç;
- (b) Asnjë fëmijë të mos i mohohet liria në mënyrë të paligjshme ose arbitrare. Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një fëmijë duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të përdoret vetëm si një masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër.
- (c) Çdo fëmijë i privuar nga liria të trajtohet në mënyrë njerëzore dhe me respektin që i takon dinjitetit të njeriut dhe në mënyrë të tillë; që të kihen parasysh nevojat e personave të moshës së tij. Në veçanti, çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të veçohet nga të rriturit, me përjashtim të rastit kur mendohet se është në interesin më të lartë të fëmijës që kjo të shmanget dhe ai të ketë të drejtën të mbajë lidhje me familjen me korrespondencë dhe vizita, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme;
- (d) Çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të ketë të drejtën që t'i jepet menjëherë ndihmë juridike ose çdo ndihmë tjetër e përshtatshme, si dhe të drejtën të kundërshtojë vendimin për heqjen e lirisë përpara një gjykate ose një autoriteti tjetër kompetent, të pavarur dhe të paanshëm si dhe për një vendim të shpejtë për çdo rast të tillë.

Neni 38

1. Shtetet Palë marrin përsipër të respektojnë dhe të bëjnë të respektohen rregullat e së drejtës humanitare ndërkombëtare, që janë të zbatueshme për ta në rast konflikti të armatosur dhe që kanë të bëjë me fëmijën.



2. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar që personat, të cilët nuk kanë mbushur moshën pesëmbëdhjetë vjeç, të mos marrin pjesë drejtpërdrejt në veprimet luftarake.

3. Shtetet Palë nuk rekrutojnë në forcat e tyre të armatosura asnjë person që nuk ka mbushur moshën pesëmbëdhjetë vjeç. Kur ata rekrutojnë persona më të rritur se 15 vjeç por më të vegjël se 18 vjeç, Shtetet Palë përpiqen të rekrutojnë më përpara më të mëdhenjtë në moshë.

4. Në përputhje me detyrimin që u takon në bazë të së drejtës humanitare ndërkombëtare, për të mbrojtur popullsinë civile në rast konflikti të armatosur, Shtetet Palë marrin të gjitha masat e mundshme, për të siguruar mbrojtjen dhe përkujdesjen për fëmijët e prekur nga konflikti i armatosur.

Neni 39

Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura për të lehtësuar riaftësimin fizik e psikologjik dhe riintegrimin në shoqëri të çdo fëmije që është viktimë: e çdo forme pakujdesie, shfrytëzimi ose keqtrajtimi, torture ose çdo forme tjetër të një trajtimi ose

dënimi mizor, çnjerëzor e poshtërues ose konflikti të armatosur. Ky riaftësim dhe ky riintegrim duhet të bëhen në kushtet e një mjedisi, që ndihmon shëndetin, personalitetin dhe dinjitetin e fëmijës.

Neni 40

1. Shtetet Palë i njohin çdo fëmije të dyshuar, të akuzuar ose për të cilin është thënë se ka kryer shkelje të ligjit penal, të drejtën e një trajtimi të tillë, që zhvillon te fëmija ndjenjën e dinjitetit dhe të vlerës së personit, që përforcon tek ai ndjenjën e respektit të tij për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve dhe që merr parasysh moshën e fëmijës si dhe dëshirën për të ndihmuar në riintegrimin e tij në shoqëri dhe në mënyrë që ai të luajë një rol konstruktiv në gjirin e saj.

2. Për këtë qëllim dhe duke pasur parasyh dispozitat përkatëse të instrumenteve ndërkombëtare, Shtetet Palë kujdesen në veçanti që:

(a) Asnjë fëmijë të mos jetë i dyshuar, i akuzuar ose i cilësuar për shkelje të ligjit penal për arsye të veprimeve ose mosveprimeve që nuk kanë qenë të ndaluara nga e drejta e brendshme ose ndërkombëtare në momentin kur ato janë kryer;

(b) Çdo fëmijë i dyshuar ose i akuzuar për shkelje të ligjit penal të ketë të paktën garancitë që vijojnë:

(i) Të prezumohet i pafajtshëm derisa të provohet pafajësia ligjërisht;

(ii) Të informohet menjëherë dhe drejtpërdrejt për akuzat e ngritura kundër tij, nëse është e përshtatshme, me anë të prindërve të tij ose të përfaqësuesve ligjorë, dhe të ketë ndihmë juridike ose nga çdo ndihmë tjetër të duhur për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes së tij;

(iii) Çështja e tij të shqyrtohet pa vonesë nga një autoritet ose instancë gjyqësore kompetente, e pavarur dhe e paanshme, sipas një procedure të drejtë ligjore, në praninë e ndihmës juridike ose të një ndihme tjetër të përshtatshme, dhe, kur gjykohet se kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, sidomos për arsye të moshës ose gjendjes së tij, në prani të prindërve ose përfaqësuesve të tij ligjorë;

- (iv) Të mos detyrohet të dëshmojë ose të pohojë veten fajtor; të pyeten ose të bëjë të pyeten dëshmitarët e akuzës dhe të sigurojë paraqitjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të mbrojtjes së tij, në kushte të barabarta.
- (v) Në qoftë se vendoset se ka shkelur ligjin penal, të bëjë ankim kundër këtij vendimi si dhe çdo masë të marrë si pasojë, para një autoriteti ose një instance gjyqësore kompetente më të lartë, të pavarur dhe të paanshme, në përputhje me ligjin.
- (vi) Të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se ai nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën që përdoret.
- (vii) Të respektohet plotësisht jeta e tij private në të gjitha fazat e procedurës.

3. Shtetet Palë përpiqen të nxisin krijimin e ligjeve, procedurave, organeve dhe institucioneve të posaçme për fëmijët që dyshohen, akuzohen ose që vlerësohen se kanë kryer shkelje të ligjit penal dhe në veçanti:

- (a) Përcaktojnë një moshe minimale, nën të cilën fëmijët prezumohen të paaftë për të shkelur ligjin penal;
- (b) Marrin masa, sa herë është e nevojshme dhe e dëshirueshme, për t'i trajtuar këta fëmijë pa iu drejtuar procedurës gjyqësore, me kusht që të respektohen plotësisht të drejtat e njeriut dhe mbrojtja ligjore.

4. Parashikohen dispozita të ndryshme, siç janë kujdesi, orientimi dhe kontrolli; këshillat; periudha e provës; kujdesi në familje; programet e edukimit të përgjithshëm dhe profesional dhe zgjidhje të tjera, veç atyre institucionale, për t'u siguruar fëmijëve një trajtim në përputhje me mirëqenien e tyre dhe në raport me gjendjen e tyre dhe me shkeljen e ligjit.

Neni 41

Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk cënon dispozitat më të favorshme për realizimin e të drejtave të fëmijës, që mund të parashikohen:

- (a) në legjislacionin e një Shteti Palë; ose
- (b) në të drejtën ndërkombëtare në fuqi për atë Shtet.

PJESA II

Neni 42

Shtetet Palë marrin përsipër t'ua bëjnë gjerësisht të njohura parimet dhe dispozitat e kësaj Konvente, si të rriturve ashtu edhe fëmijëve, me anë të mjeteve energjike të përshtatshme.

Neni 43

1. Me qëllim që të shqyrtohen përparimet e arritura nga Shtetet Palë në përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër prej tyre në bazë të kësaj Konvente, krijohet një Komitet mbi të Drejtat e Fëmijës, i cili kryen funksionet e caktuara si më poshtë.



2. Komiteti përbëhet nga dhjetë ekspertë me moral të lartë dhe që njihen si kompetentë në fushën që trajton kjo Konventë. Anëtarët e tij zgjidhen nga Shtetet Palë midis shtetasve të tyre dhe marrin pjesë me titull personal, duke pasur parasysh një shpërndarje gjeografike të drejtë dhe sistemet juridike kryesore.
3. Anëtarët e Komitetit zgjidhen me votë të fshehtë, nga një listë personash të caktuar nga Shtetet Palë. Çdo Shtet Palë mund të caktojë një kandidat nga shtetasit e tij.
4. Zgjedhja e parë bëhet jo më vonë se gjashtë muaj nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Më pas zgjedhjet bëhen çdo dy vjet. Të paktën katër muaj para datës së çdo zgjedhjeje, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara fton me shkrim Shtetet Palë të propozojnë kandidatët e tyre brenda një afati dymujor. Sekretari i Përgjithshëm bën më pas listën alfabetike të kandidatëve të caktuar, duke cilësuar Shtetet Palë që i kanë caktuar dhe ua paraqit ata Shteteve Palë në këtë Konventë.
5. Zgjedhjet bëhen gjatë mbledhjeve të Shteteve Palë, të organizuara nga Sekretari i Përgjithshëm në Selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Në këto mbledhje, në të cilat duhet të jenë të pranishëm jo më pak se dy të tretat e Shteteve Palë, kandidatët të zgjedhur në Komitet janë ata që fitojnë numrin më të madh të votave dhe shumicën absolute të votave të Shteteve Palë të pranishëm dhe votues.
6. Anëtarët e Komitetit zgjidhen për një mandat katërvjeçar. Ata mund të rizgjidhen në qoftë se kandidatura e tyre paraqitet përsëri. Mandati i pesë prej anëtarëve të zgjedhur në zgjedhjen e parë mbaron pas dy vjetësh. Emrat e këtyre pesë anëtarëve hidhen në short nga Kryetari i mbledhjes, menjëherë pas zgjedhjes së parë.
7. Në rast se një anëtar i Komitetit vdes ose jep dorëheqjen ose deklaron se për çdo arsye tjetër nuk mund t'i kryejë më funksionet e tij në Komitet, Shteti Palë, që kishte paraqitur kandidaturën e tij, emëron një tjetër ekspert nga shtetasit e vet, për të plotësuar vendin e lirë deri në përfundimin e mandatit korrespondues, gjë që i nënshtrohet miratimit të Komitetit.
8. Komiteti miraton rregulloren e tij të brendshme.
9. Komiteti zgjedh byronë e tij për një periudhë prej dy vjetësh.
10. Mbledhjet e Komitetit zakonisht mbahen në Selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara ose në çdo vend tjetër të përshtatshëm, të caktuar nga Komiteti. Komiteti mbledhet zakonisht çdo vit. Zgjatja e sesioneve të tij përcaktohet dhe ndryshohet, në rast se është e nevojshme, nga një mbledhje e Shteteve Palë në këtë Konventë, me rezervën e miratimit nga Asambleja e Përgjithshme.

11. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara vë në dispozicion të Komitetit personelin dhe pajisjet e nevojshme, për të kryer me efektshmëri funksionet që i janë besuar në bazë të Konventës.

12. Me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme, anëtarët e Komitetit të krijuar në bazë të kësaj Konvente paguhën nga të ardhurat e OKB-së, sipas kushteve dhe modaliteteve të caktuara nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 44

1. Shtetet Palë marrin përsipër të paraqitin në Komitet, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, raporte mbi masat e marra për të përmbushur të drejtat e njohura në këtë Konventë dhe mbi përparimet e realizuara në gëzimin e këtyre të drejtave:

- (a) Brenda dy vjetëve, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për Shtetet Palë;
- (b) Në vazhdim në çdo pesë vjet.

2. Raportet e paraqitura në zbatim të këtij neni tregojnë faktorët dhe vështirësitë, në rast se ka, që kanë ndikuar në shkallën e përmbushjes nga Shtetet Palë të detyrimeve të parashikuara në këtë Konventë. Raportet duhet të përmbajnë gjithashtu të dhëna të mjaftueshme për t'i dhënë Komitetit një ide të plotë për zbatimin e Konventës në vendin përkatës.

3. Shtetet Palë, që kanë paraqitur në Komitet raportin e parë të plotë, nuk përsërisin në raportet që i paraqesin atij në vazhdim, sipas pikës (b) të paragrafit të parë të këtij neni, sqarimet kryesore, të komunikuar qysh më parë.

4. Komiteti mund t'u kërkojë Shteteve Palë të dhëna plotësuese, që kanë të bëjnë me zbatimin e Konventës.

5. Komiteti i paraqit çdo dy vjet Asamblesë së Përgjithshme, nëpërmjet Këshillit Ekonomik dhe Shoqëror, një raport mbi veprimtarinë e tij.

6. Shtetet Palë sigurojnë një shpërndarje të gjerë të raporteve të tyre në vendet e tyre.

Neni 45

Për të arritur zbatimin efektiv të Konventës dhe për të inkurajuar bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën që mbulon kjo Konventë:

- (a) Agjencitë e specializuara, Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe organe të tjera të Kombeve të Bashkuara, kanë të drejtë të përfaqësohen gjatë shqyrtimit të zbatimit të dispozitave të kësaj Konvente, që kanë të bëjnë me mandatin e tyre. Komiteti mund të ftojë agjencitë e specializuara, Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe të gjitha organet e tjera kompetente



që ai do ta gjykojë të arsyeshme, për të dhënë mendime të specializuara mbi zbatimin e Konventës në fusha që kanë të bëjnë me mandatin e tyre përkatës. Ai mund të ftojë agjencitë e specializuara, Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe organe të tjera të Kombeve të Bashkuara për t'i paraqitur raporte mbi zbatimin e Konventës në sektorët që kanë të bëjnë me fushën e veprimtarisë së tyre;

(b) Komiteti u transmeton agjencive të specializuara, Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe organeve të tjera kompetente, në rast se e sheh të nevojshme, çdo raport të Shteteve Palë, që përmban një kërkesë ose që tregon një nevojë për këshilla ose ndihmë teknike, së bashku me vërejtjet dhe sugjerimet e Komitetit, në rast se ka të tilla;

(c) Komiteti mund t'i rekomandojë Asamblesë së Përgjithshme, që t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm, të ndër marrë në emër të tij studime për çështje të veçanta, që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijës;

(d) Komiteti mund të bëjë sugjerime dhe rekomandime të përgjithshme, të bazuara në të dhënat e marra në zbatim të neneve 44 dhe 45 të kësaj Konvente. Këto sugjerime dhe rekomandime të natyrës së përgjithshme i transmetohen çdo Shteti Palë të interesuar dhe i përcillen për dijeni Asamblesë së Përgjithshme, të shoqëruara, në rast se ka të tilla, me vërejtjet e Shteteve Palë.

PJESA III

Neni 46

Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga të gjithë Shtetet.

Neni 47

Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit. Instrumentet e ratifikimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 48

Konventa do të qëndrojë e hapur për aderim nga çdo Shtet. Instrumentet e aderimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 49

1. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të instrumentit të njëzetë të ratifikimit ose aderimit.
2. Për secilin Shtet që ratifikon këtë Konventë ose aderon në të, pas depozitimit të instrumentit të njëzetë të ratifikimit ose aderimit, Konventa hyn në fuqi ditën e tridhjetë pas depozitimit nga ky Shtet, të instrumentit të tij të ratifikimit ose aderimit.

Neni 50

1. Çdo Shtet Palë mund të propozojë një amendament dhe të depozitojë tekstin pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm ua komunikon pastaj amendamentin e propozuar Shteteve Palë, duke kërkuar që t'i bëjnë të ditur nëse janë për thirrjen e një konference të Shteteve Palë për shqyrtimin e propozimit dhe të hedhjes në votë. Nëse brenda katër muajve pas datës së këtij komunikimi, të paktën një e treta e Shteteve Palë shprehen për thirrjen e një konference të tillë, Sekretari i Përgjithshëm thërret konferencën nën përkujdesjen e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Çdo amendament i miratuar nga shumica e Shteteve Palë të pranishëm dhe votues në konferencë i paraqitet për miratim Asamblesë së Përgjithshme.

2. Një amendament i miratuar në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni hyn në fuqi pasi të jetë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe të jetë pranuar nga dy të tretat e Shteteve Palë.

3. Kur një amendament hyn në fuqi, ai bëhet i detyrueshëm për të gjithë Shtetet Palë, që e kanë pranuar dhe Shtetet e tjerë që mbeten të lidhur me dispozitat e kësaj Konvente dhe me të gjithë amendamentet e mëparshme të pranuar prej tyre.

Neni 51

1. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara merr dhe ua dërgon të gjithë Shteteve tekstin e rezervave të bëra nga Shtetet në çastin e ratifikimit ose të aderimit.

2. Nuk lejohet asnjë rezervë e papajtueshme me objektin dhe qëllimin e kësaj Konvente.

3. Rezervat mund të tërhiqen në çdo kohë, nëpërmjet njoftimit drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili informon për këtë të gjithë Shtetet Palë në Konventë. Njoftimi hyn në fuqi në datën kur ky është marrë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 52

Çdo Shtet Palë mund ta denoncojë këtë Konventë me anë të një njoftimi me shkrim, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Denoncimi hyn në fuqi një vit pas datës kur njoftimi është marrë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 53

Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara caktohet si depozitues i kësaj Konvente.

Neni 54

Origjinali i kësaj Konvente, bërë në gjuhët angleze, arabe, kineze, spanjolle, franceze dhe ruse, me vlerë të barabartë, depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Për vërtetim, të nënshkruarit, të plotfuqishëm e të ngarkuar ligjërisht nga qeveritë përkatëse, nënshkruan këtë Konventë.



Organizata partnere e Cilësisë për Fëmijët

FICE (Federata Ndërkombëtare për Arsimimin e Komunitetit- FNAK)

Qëllimi kryesor i FNAK-së është ndihmë për kujdesjen ndaj fëmijës dhe të riut në tërë botën.

FNAK:

- pranon individualitetin e fëmijës, të riut dhe prindërve të tyre dhe nuk i detyron ata që të pajtohen me normat e paracaktuara;
- përkrah familjen si strukturë themelore sociale për ngritjen e fëmijëve;
- përkrah arsimimin dhe kujdesjen më të lartë për fëmijët dhe të rinjtë që nuk mund të jetojnë në shtëpi;
- përpiqet të gjej zgjidhje individuale për të përshtatur nevojat e çdo fëmije ose të riut;
- inkurajon zhvillimin e vazhdueshëm të shërbimeve për fëmijët nëpërmjet hulumtimit dhe risive teorike;
- Punës e saj kryen në bazë të Konventës për të Drejtat e Fëmijës e Kombeve të Bashkuara;
- në mënyrë të përpiktë zbaton neutralitetin politik dhe fetar;
- vlerëson diversitetin dhe hedh poshtë të gjitha format e diskriminimit në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit, bindjen politike dhe biologjike e shoqërore

Me qëllim që të përmbush qëllimet e veta, FNAK:

- punon përmes organizatave vendore, anëtarët e të cilave ofrojnë shërbime për fëmijët dhe të rinjtë, ose punojnë në shërbimet përkrahëse siç është trajnimi i punëtorëve ose menaxhimi i shërbimeve;
- përkrah organizatat anëtare vendore përmes krijimit të rrjeteve për kontakt;
- organizon kongrese të rëndësishme ndërkombëtare, zakonisht çdo dy vite;
- përkrah projektet që përfshijnë kontaktet ndërkombëtare ndërmjet fëmijëve, të rinjve dhe të atyre që kujdesen për ta siç janë Kampet Ballkanike të Miqësisë;
- inkurajon shkëmbime ndërkombëtare të punëtorëve dhe / ose fëmijëve dhe të rinjve;
- ofron Programe për shkëmbime profesionale për punëtorët me përvojë;
- organizon seminare ndërkombëtare, punëtori me ekspert dhe palë punuese mbi çështjet që kanë të bëjnë me shërbimet për fëmijët dhe të rinjtë;
- këshillohet me UNESCO-n, Bashkimin Evropian, Këshillin e Evropës, ECOSOC dhe organet tjera ndërkombëtare;
- ofron informata dhe mundësi përmes rrjetit të web faqes së vet;
- shpërndan ide të reja dhe gjetjet e hulumtimeve në publikimet e veta



IFCO (Organizata Ndërkombëtare e Strehimit Familjar -ONSF)

Organizata Ndërkombëtare e Strehimit Familjar (ONSF) është e vetmja organizatë ndërkombëtare në botë që i përkushtohet vetëm mbështetjes dhe përkrahjes të përkujdesjes të bazuar në familje dhe përkujdesjes strehues. ONSF ishte themeluar në vitin 1981 në Oksford (Mbretëria e Bashkuar) si një platformë për shkëmbimin e informatave, njohurive dhe përvojave ndërmjet të gjitha organizatave të përkujdesjes të strehimit dhe palëve të tjera të përkujdesjes të strehimit në tërë botën. ONSF organizon rrjete ndërkombëtare, konferenca ndërkombëtare dhe seminare trajnimi, boton një revistë, një buletin informativ, dhe ofron një web faqe informative. ONSF ka një komponent të fortë me prezencën e të rinjve dhe të përfshirë në të gjitha nivelet dhe të gjitha aktivitetet.

ONSF ka anëtarë në më se 60 shtete. Përveç që është e përkushtuar të ofrojë shërbime cilësore tek të gjithë anëtarët e saj, viteve të fundit organizata ka zhvilluar një komponentë të fuqishme të projektit, të koordinuar nga zyra qendrore që gjendet në Hagë, Holandë. Përmes anëtarëve të saj dhe organizatave partnere, ONSF ofron këshillime dhe ndihmë në zhvillimin e shërbimeve strehuese në shumë pjesë të botës. Këshillimi gjithmonë ofrohet në bashkëpunim të ngushtë me shtetin që është i përfshirë dhe me partnerët në rajon. Një grup ekspertësh ndërkombëtar është në dispozicion të ofroj ekspertizë afat shkurtër në projektet e tilla.

Më tepër për ONSF-në mund të gjeni në web faqen www.ifco.info ose përmes zyrës koordinuese në Hagë, Holandë.

SOS Fshati i Fëmijëve

SOS Fshati i parë i fëmijëve ishte themeluar në vitin 1949 në Imst, Austri. Ishte i përkushtuar që ti ndihmojë fëmijëve nevojtarë- fëmijët që i kanë humbur shtëpitë e tyre, sigurinë dhe familjet e tyre si pasojë e luftës së dytë botërore.

Sot, SOS Fshati ndërkombëtar është organizatë mbrojtëse për më tepër se 130 asociacione anëtare të SOS Fshatit të fëmijëve në mbarë botën. Ofron kujdes të bazuar në familje për fëmijët që kanë humbur prindërit e vet ose që nuk mund të jetojnë me ata. Po ashtu, përkrah fëmijët e cenuar dhe familjet e tyre përmes programeve që kanë për qëllim forcimin e aftësive të tyre përballuese, duke siguruar qasjen e tyre në shërbimet esenciale dhe përkrahje shëndetësore, arsimore dhe psiko-sociale.

SOS Fshati i fëmijëve punon në frymën e Konventës për të Drejtat e Fëmijës e Kombeve të Bashkuara dhe përkrah këto të drejta në tërë botën. Mban status konsultativ me Këshillin Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara dhe është anëtare e Grupit të Veprimit i të Drejtave të Fëmijës që përkrah Strategjinë e Bashkimit Evropian për të Drejtat e Fëmijës.



Stampimi

Përgjegjës për përmbajtjen: Cilësia për fëmijët

Një iniciativë nga FNAK, ONSF dhe SOS Fshatit të Fëmijëve
Rruga Hermann Gmeiner . 51
A-6010 Innsbruck
Austri
Telefoni: +43-512-3316-0
Faksi: +43-512-3316-5686
Email: quality4children@sos-kd.org
www.quality4children.info

Drejtoret e projektit:

Werner Hilweg
Christian Posch

Koordinatorët e projektit:

Oscar Germes Castro
Mai Nguyen-Feichtner

Të rinjtë e CPF:

Svein Even Borgen (NO)
Sandra Burger (AT)
Judith Johansen (NO)
Kersti Kukk (EE)
Alexandar Milanov (BG)
Ingrida Peciulyte (LT)

Helen Rid (AT)
Amalia Serban (RO)
Emmanuel Sherwin (IE)
Rinske van Sloten (NL)
Odd Eigil Sporck (NO)
Johann Weissensteiner (AT)

Grupi Drejtues:

Sandra Burger
Else Dugstad
Chris Gardiner
Oscar Germes Castro
Werner Hilweg
Janneke Holwerda-Kuipers
Mai Nguyen-Feichtner

Monika Niederle
Christian Posch
Ivanka Shalapatova
Emmanuel Sherwin
Bettina Terp
Bep van Sloten
Rinske van Sloten

**Koordinatorët kombëtar:**

Carola Bengtsson (SE)
Francesco Colizzi (IT)
Kurt De Backer (BE)
Maria Dantcheva (BG)
Carmen Delgado (ES)
Tanja Gregorec (SI)
Bragi Gudbrandsson (IS)
Sabine Hartig (DE)
Soren Hegstrup (DK)
Keith Henderson (IE)
Maria Herczog (HU)
Emine Insay (Northern Cyprus)
Dale Kabasinskaite (LT)
Gosiray Koun (TR)
Michel Krier (LU)

Ryszard Kucha (PL)
Anne Marie Le Tourneau (GB)
Irena Liepina (LV)
Juha Luomala (FI)
Michaela Marksova-Tominova (CZ)
Slavenka Martinovic (HR)
Elmet Puhm (EE)
John Role (MT)
Isabel Rufino (PT)
Daniela Serban (RO)
Stergios Sifnios (GR)
Katerina Slesingerova (CZ)
Annegret Wigger (CH)
Daniela Zilincikova (SK)

Korektorët:

Kathrin Bielowski
Christine Davey
Markus Claus Egger

Beatrix Fleischmann
Thomas Harvey Timlin

Partnerët e fidbekut:

Veronique Lerch
Kelig Puyet
Elisabeth Ullmann

Raluca Verweijen-Slannescu
Annegret Wigger

Korniza e referencës:

Mbrojtja Ndërkombëtare për Fëmijët, Holandë

